FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.18 19 shkurt 2008

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9866 datë 31.1.2008	Për ratifikimin e "Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për asociimin e Republikës së Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe të veprimtarive të demonstrimit (2007-2013)"..	621
Ligj nr.9867 datë 31.1.2008	Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër ……	629
Ligj nr.9868 datë 4.2.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura" ……	640
Ligj nr.9869 datë 4.2.2008	Për huamarrjen e qeverisjes vendore ……	644
Ligj nr.9870 datë 4.2.2008	Për standardizimin ……	653
Vendim i Kuvendit nr.157, datë 14.2.2008	Për një ndryshim në përbërjen e Komisionit Hetimor "Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave"……	660

LIGJ
Nr.9866, datë 31.1.2008

PËR RATIFIKIMIN E "MEMORANDUMIT TË MIRËKUPTIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR ASOCIIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E SHTATË KUADËR TË KOMUNITETIT EUROPIAN PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN TEKNOLOGJIK DHE TË VEPRIMTARIVE TË DEMONSTRIMIT (2007-2013)"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për asociimin e Republikës së Shqipërisë në programin e shtatë kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe të veprimtarive të demonstrimit (2007-2013)".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5619, datë 14.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN MBI ASOCIIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E SHTATË KUADËR TË KOMUNITETIT EUROPIAN PËR KËRKIMIN, ZHVILLIMIN TEKNOLOGJIK DHE AKTIVITETEVE TË DEMONSTRIMIT (2007-2013)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në emër të Republikës së Shqipërisë, këtu e quajtur "Shqipëria" nga njëra anë, dhe Komisioni i Komuniteteve Europiane, këtu quhet "Komisioni", në emër të Komunitetit Europian, këtu i quajtur "Komuniteti", nga ana tjetër, këtu të quajtura së bashku "Palët",

ndërsa:

1. Marrëveshja Kuadër ndërmjet Komunitetit Europian dhe Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit u miratua më 6 qershor 2005 dhe hyri në fuqi më 11 korrik 2005 (këtu quhet "Marrëveshja Kuadër"), duke lënë Komisionin dhe autoritetet kompetente të Shqipërisë për të përcaktuar termat dhe kushtet specifike, duke përfshirë kontributin financiar, në lidhje me këtë pjesëmarrje në secilin program të caktuar;

2. Parlamenti Europian dhe Këshilli, miratuan më 18 dhjetor 2006 vendimin nr.1982/2006/EC në lidhje me Programin e Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknik dhe aktivitetet e demonstrimit (2007-2013)[1] (këtu i quajtur "Programi i Shtatë Kuadër i KE-së"),

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

[1] GZ L412, datë 30/12/2006, f.1.

Programet e kërkimit

Shqipëria do të marrë pjesë në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së duke përfshirë programet e mëposhtme specifike dhe në pajtim me rregullat për pjesëmarrjen:

Vendimin e Këshillit nr.971/2006/EC të 19 dhjetorit 2006 në lidhje me programin specifik,

Bashkëpunimi, në zbatim të Programit të Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktivitetet e demonstrimit (2007 deri 2013)[2];

Vendimin e Këshillit nr.2006/972/EC të 19 dhjetorit 2006 në lidhje me programin specifik,

Idetë, në zbatim të Programit te Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktivitetet e demonstrimit (2007 deri 2013)[3];

Vendimin e Këshillit nr.2006/973/EC të 19 dhjetorit 2006 në lidhje me programin specifik,

Njerëzit, në zbatim të Programit të Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktivitetet e demonstrimit (2007 deri 2013)[4];

Vendimin e Këshillit nr.2006/974/EC të 19 dhjetorit 2006 në lidhje me programin specifik,

Kapacitetet, në zbatim të Programit të Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktivitetet e demonstrimit (2007 deri 2013[5];

Vendimin e Këshillit nr.2006/975/EC të 19 dhjetorit 2006 në lidhje me programet specifike që duhet të zbatohen nëpërmjet veprimeve të drejtpërdrejta nga Qendra e Përbashkët e Kërkimeve në bazë të Programit të Shtatë Kuadër të Komunitetit Europian për kërkimin, zhvillimin teknologjik dhe aktivitetet e demonstrimit (20072013)[6];

Rregulloren (EC) nr 1906/2006 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 18 dhjetorit 2006 që cakton rregullat për pjesëmarrjen e sipërmarrjeve, qendrave të kërkimeve dhe universiteteve në veprimet nën Programin e Shtatë Kuadër dhe për shpërndarjen e rezultateve të kërkimeve (2007-2013)[7].

Neni 2

Termat dhe kushtet në lidhje me pjesëmarrjen në programe

1. Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e Programit të Shtatë Kuadër të KE-së në pajtim me kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen Kuadër dhe në pajtim me objektivat, termat dhe kushtet e përcaktuara në këtë Memorandum mirëkuptimi dhe anekset e tij.

2. Subjektet juridike të themeluara në Shqipëri marrin pjesë në veprimet jo të drejtpërdrejta të Programit të Shtatë Kuadër të KE-së nën të njëjtat kushte si ato që zbatohen për subjektet juridike të Shteteve Anëtare të BE-së, në pajtim me termat dhe kushtet e vendosura ose referuara në këtë memorandum mirëkuptimi dhe siç përcaktohet në aneksin I.

3. Për pjesëmarrjen në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së, Shqipëria do të paguajë kontributin e saj financiar në buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane në pajtim me nenin 3 të mëposhtëm dhe aneksin II.

4. Përfaqësuesit e Shqipërisë do të marrin pjesë si vëzhgues dhe për çështjet që kanë të bëjnë me Shqipërinë në komitetet menaxheriale përgjegjës për monitorimin e programeve specifike sipas Programit të Shtatë Kuadër të KE-së, për të cilët Shqipëria kontribuon financiarisht.

Këto komitete do të takohen pa praninë e përfaqësuesve të Shqipërisë në momentin e votimit. Shqipëria do të informohet për rezultatin.

Pjesëmarrja e përmendur në këtë paragraf merr të njëjtën formë, duke përfshirë procedurat e marrjes së informacionit dhe dokumentacionit, si ajo që zbatohet për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian.

5. Përfaqësuesit e Shqipërisë do të marrim pjesë si vëzhgues në Bordin e Guvernatorëve të Qendrës së Përbashkët të Kërkimeve.[8]

Pjesëmarrja e përmendur në këtë paragraf merr të njëjtën formë, duke përfshirë procedurat për marrjen e informacionit dhe dokumentacionit, si ajo që zbatohet për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian.

---

[2] GZ L400, datë 30/12/2006, f.86.
[3]GZ L400 datë 30/12/2006, f.243.
[4]GZ L400, datë 30/12/2006, f.207.
[5]GZ L400, datë 30/12/2006, f.299.
[6]GZ L400, datë 30/12/2006. f.368.
[7]GZ L391, datë 30/12/2006, f.1.
[8]GZ L 107, datë 30/4/1996, f.12.

6. Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e qëndrimit që shkaktohen nga përfaqësuesit e Shqipërisë që marrin pjesë në mbledhjet e komiteteve dhe organeve të përmendura në këtë Memorandum mirëkuptimi, ose në mbledhjet në lidhje me zbatimin e Programit të Shtatë Kuadër të KE-së, ose të këtij Memorandumi mirëkuptimi, rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në pajtim me procedurat tashmë në fuqi për përfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian.

7. Një nga gjuhët zyrtare të Komunitetit përdoret për procedurat në lidhje me kërkesat, marrëveshjet e grantit dhe/ose kontratat dhe raportet, si dhe për aspekte të tjera administrative të Programit të Shtatë Kuadër të KE-së.

Neni 3

Kontributi financiar i Shqipërisë

1. Rregullat që rregullojnë llogaritjen dhe pagesën e kontributit financiar të Shqipërisë janë përcaktuar në aneksin II.

2. Kontributi financiar i Shqipërisë i shtohet shumës së caktuar çdo vit në buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane për llogaritjen e përkushtimeve për përmbushjen e detyrimeve financiare, që rrjedhin nga forma të ndryshme të masave të nevojshme për zbatimin, menaxhimin dhe operimin e Programit të Shtatë Kuadër të KE-së.

3. Shqipëria do të paguajë për çdo vit të Programit të Shtatë Kuadër të KE-së një kontribut financiar në buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane.

Pjesë e kontributit financiar të Shqipërisë mund të financohet sipas instrumentit përkatës së ndihmës së jashtme të Komunitetit, nëse Shqipëria e kërkon këtë.

Neni 4

Raportimi dhe vlerësimi

1. Shqipëria i paraqet Komisionit raporte përkatëse dhe merr pjesë në aktivitete të tjera specifike të parashikuara nga Komuniteti në kontekstin e Programit të Shtatë Kuadër të KE-së.

2. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës së Auditëve të Komuniteteve Europiane në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit të Shtatë Kuadër të KE-së, pjesëmarrja e Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së do të monitorohet vazhdimisht mbi një bazë partneriteti duke përfshirë Komisionin dhe Shqipërinë.

3. Rregullat në lidhje me kontrollin financiar, rikuperimin dhe masa të tjera kundër mashtrimit janë parashikuar në aneksin III.

Neni 5

Të drejtat e pronësisë intelektuale

1. “Pronësi intelektuale” ka kuptimin e dhënë në nenin 2 të konventës themeluese të Organizatës Botërore të Pronësisë Intelektuale, bërë në Stokholm më 14 korrik 1967.

2. Të drejtat e pronësisë intelektuale të krijuara ose të dhëna në bazë të këtij Memorandumi mirëkuptimi jepen në pajtim me rregullat për pjesëmarrjen dhe dispozitat e marrëveshjes model të grantit të Programit të Shtatë Kuadër të KE-së.

Neni 6

Dispozita të fundit

1. Ky Memorandum mirëkuptimi zbatohet për kohëzgjatjen e Programit të Shtatë Kuadër të KE-së, nga 1 janari 2008.

2. Ai mund të prishet nga të dy Palët në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes së Programit të Shtatë Kuadër të KE-së, nëpërmjet një njoftimi me shkrim që informon në lidhje me qëllimin për të prishur marrëveshjen e asocimit. Në pajtim me paragrafin 3 të mëposhtëm, pushimi i fuqisë hyn në fuqi tre muaj kalendarikë pas datës së njoftimit me shkrim.

3. Projektet dhe aktivitetet në vazhdimësi në momentin e pushimit të fuqisë dhe/ose skadimit të këtij Memorandumi mirëkuptimi vazhdojnë deri në përfundim të tyre sipas kushteve të përcaktuara në këtë Memorandum Mirëkuptimi.

4. Anekset formojnë një pjesë integrale të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

5. Ky memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqim të përbashkët të Palëve.

6. Asocimi i Shqipërisë në programet pasuese kuadër, nëse Shqipëria e kërkon këtë, i nënshtrohet një memorandumi të ri mirëkuptimi që bihet dakord ndërmjet Palëve.

Neni 7

Hyrja në fuqi

1. Ky Memorandum mirëkuptimi zbatohet në mënyrë provizore që nga 1 janari 2008.

2. Ky Memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi në datën kur Shqipëria ka njoftuar Komisionin që janë përmbushur të gjitha kushtet e nevojshme të brendshme për hyrjen në fuqi të këtij Memorandumi Mirëkuptimi.

Bërë në Bruksel, më 17 dhjetor 2007, në dy kopje origjinale, në gjuhët shqip dhe anglisht, ku secili prej këtyre teksteve ka të njëjtën vlerë.

ANEKSI I

TERMAT DHE KUSHTET PËR PJESËMARRJEN E SUBJEKTEVE JURIDIKE TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E SHTATË KUADËR TË KE-SË

1. Për qëllimin e pjesëmarrjes së Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së, një subjekt juridik i Shqipërisë përkufizohet si një person fizik ose person juridik i themeluar në Shqipëri sipas ligjit të brendshëm, që ka personalitet juridik dhe që, duke vepruar në emër të vet, mund të ushtrojë të drejtat dhe t'u nënshtrohet detyrimeve. Në rastin e personave fizikë, referencat për themelimin mendohen t'i referohen vendbanimit të zakonshëm.

2. Pjesëmarrja e subjekteve juridike të Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së bëhet sipas kushteve të përcaktuara për subjektet juridike që janë themeluar në një "vend të asociuar", sipas përcaktimit në rregullat për pjesëmarrjen.

Në rast se Komuniteti merr masat për zbatimin e neneve 169 dhe 171 të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian, Shqipëria lejohet të marrë pjesë në strukturat ligjore të krijuara sipas këtyre dispozitave, duke iu nënshtruar vendimeve dhe rregulloreve që do të miratohen për themelimin e këtyre strukturave ligjore dhe me kusht që këto vendime dhe rregullore të bëhen të zbatueshme në Shqipëri. Komiteti i Përbashkët vendos mbi zbatueshmërinë e këtyre vendimeve dhe rregulloreve në Shqipëri.

Subjektet juridike të themeluara në Shqipëri janë të përshtatshme për pjesëmarrje në veprimet jo të drejtpërdrejta bazuar në nenet 169 dhe 171 të Traktatit Themelues të Komunitetit Europian në të njëjtat kushte si subjektet juridike të themeluara në Shtetet Anëtare.

Subjektet juridike të themeluara në Shqipëri janë të përshtatshme, në të njëjtat kushte, si dhe subjektet juridike të themeluara në Shtetet Anëtare, për hua që EIB-ja jep në mbështetje të objektivave kërkimore të përcaktuara në bazë të Programit të Shtatë Kuadër të KE-së (Instrumenti financiar i ndarjes së riskut).

Një subjekt juridik i themeluar në një vend tjetër të asociuar në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së (vendi i asociuar) gëzon të njëjtat të drejta dhe detyrime sipas këtij Memorandumi mirëkuptimi si subjektet ligjore që janë themeluar në një Shtet Anëtar, me kusht që ky vend i asociuar në të cilin është themeluar subjekti të ketë rënë dakord t'u japë subjekteve juridike nga vende të tjera të asociuara të njëjtat të drejta dhe detyrime.

3. Subjektet juridike të Shqipërisë merren parasysh, së bashku me ato Komunitare, për përzgjedhjen e ekspertëve të pavarur për detyrat, dhe në bazë të kushteve të parashikuara në rregullat për pjesëmarrjen.

4. Në pajtim me rregullat për pjesëmarrje në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së dhe rregulloren financiare të Komunitetit, marrëveshjet e grantit dhe/ose kontratat e lidhura nga Komuniteti me një subjekt juridik të Shqipërisë me qëllim që të kryhet një veprim jo i drejtpërdrejtë, parashikojnë kontrolle dhe auditime që kryhen nga, ose nën autoritetin e Komisionit, duke përfshirë Zyrën Europiane Kundër Mashtrimit (këtu quhet OLAF), dhe Gjykatën e Auditëve të Komuniteteve Europiane. Në frymën e bashkëpunimit dhe interesit të përbashkët, Autoritetet përkatëse të Shqipërisë japin çdo asistencë të arsyeshme dhe të mundshme, që mund të jetë e nevojshme ose ndihmëse apo e kërkuar sipas rrethanave për përmbushjen e këtyre kontrolleve dhe auditimeve.

5. Palët bëjnë çdo përpjekje, brenda kuadrit të dispozitave ekzistuese, për të lehtësuar lëvizjen e

lirë dhe vendqëndrimin e punonjësve kërkimorë që marrin pjesë në aktivitetet e mbuluara nga ky Memorandum mirëkuptimi dhe për të lehtësuar lëvizjen ndërkufitare të mallrave dhe shërbimeve që synohen për përdorim në të tilla aktivitete.

6. Një komitet i përbashkët krijohet sipas këtij Memorandumi mirëkuptimi, që quhet "Komiteti Kërkimor Shqipëri — KE", funksionet e të cilit përfshijnë:

- rishikimin, vlerësimin dhe diskutimin e masave për sigurimin e zbatimit të këtij Memorandumi mirëkuptimi;
- shqyrtimin e masave të një natyre për përmirësimin dhe zhvillimin e bashkëpunimit;
- Komiteti, që përbëhet nga përfaqësues të Komisionit dhe Shqipërisë, miraton rregullat e veta procedurale. Ai mblidhet me kërkesë të një prej Palëve dhe të paktën një herë në vit.

7. Për qëllimin e pjesëmarrjes në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së, Komiteti mund të identifikojë me kërkesë të Shqipërisë, rajonet e përshtatshme në Shqipëri që përputhen me nivelin 2 të klasifikimit të përbashkët të njësive territoriale për statistikat brenda kuptimit të rregullores (EC) nr. 1059/2003 produkti i të cilave i brendshëm bruto (PBB) për frymë, të matur sipas kursit të fuqisë blerëse dhe llogaritur mbi bazën e shifrave të Komunitetit për periudhën 2000 — 2002, është më pak se 75% e PBB-së mesatare të BE-25 për të njëjtën periudhë reference.

ANEKSI II
RREGULLAT QË RREGULLOJNË KONTRIBUTIN FINANCIAR TË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN E SHTATË KUADËR TË KE-SË

I. Llogaritja e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Kontributi financiar i Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së në vitin 2008 do të përcaktohet në raport me dhe si shtesë në shumën e ofruar atë vit në buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane për llogaritjen e përkushtimeve që nevojiten për zbatimin, menaxhimin dhe operimin e Programit të Shtatë Kuadër të KE-së.

2. Faktori i proporcionalitetit që rregullon kontributin e Shqipërisë përftohet duke caktuar raportin ndërmjet produktit të brendshëm bruto të Shqipërisë, me çmimet e tregut, dhe shumës së produkteve të brendshme bruto, me çmimet e tregut, të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian dhe Shqipërisë.

Ky raport do të llogaritet mbi bazën e të dhënave të fundit statistikore që i takojnë të njëjtit vit nga Zyra Statistikore e Komuniteteve Europiane (Eurostat), që disponohet në momentin e publikimit të projektbuxhetit paraprak të Komuniteteve Europiane. Megjithatë, për vitet pas vitit të parë të asocimit në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së, produkti i brendshëm bruto i Shqipërisë do të llogaritet me të njëjtën rritje si produkti i brendshëm bruto i Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian.

3. Me qëllim që të lehtësohet pjesëmarrja e saj në programe të veçanta, kontributi i Shqipërisë do të zbatohet për vitet përkatëse financiare, si më poshtë:

- Viti financiar 2008: kontributi në pajtim me faktorin e proporcionalitetit të caktuar në pajtim me paragrafin 2, shumëzuar me 0.20;
- Viti financiar 2009: kontributi në pajtim me faktorin e proporcionalitetit të caktuar në pajtim me paragrafin 2, shumëzuar me 0.25;
- Viti financiar 2010: kontributi në pajtim me faktorin e proporcionalitetit të caktuar në pajtim me paragrafin 2, shumëzuar me 0.30;
- Viti financiar 2011: kontributi në pajtim me faktorin e proporcionalitetit të caktuar në pajtim me paragrafin 2, shumëzuar me 0.35;
- Viti financiar 2012: kontributi në pajtim me faktorin e proporcionalitetit të caktuar në pajtim me paragrafin 2, shumëzuar me 0.40;
- Viti financiar 2013: kontributi në pajtim me faktorin e proporcionalitetit të caktuar në pajtim me paragrafin 2, shumëzuar me 0.45.

4. Formula e zbatuar për të llogaritur kontributet financiare të Shqipërisë do të rishikohet në vitin 2009 dhe bazuar në këtë vlerësim, Komisioni mund të propozojë të ndryshojë këtë Memorandum mirëkuptimi për të përshtatur, që nga viti financiar 2010, faktorin e kontributit, duke marrë parasysh ndërmarrjen nga Shqipëria të projekteve të përbashkëta për kërkime, nga njëra anë, dhe përpjekjet e bëra nga Shqipëria për të zhvilluar me tej kapacitetet e saj të kërkimit, nga ana tjetër. Vlerësimi do të shqyrtojë, gjithashtu rregullisht tiparet e reja të Programit të Shtatë Kuadër të KE-së.

5. Komisioni i komunikon Shqipërisë, sa më parë të jetë e mundur dhe jo më vonë se 1 shtatori i

vitit përpara çdo viti financiar, informacionin e mëposhtëm së bashku me materialin përkatës paraprak:

- shumat në llogaritjet e përkushtimeve në deklarimin e shpenzimeve të projektbuxhetit paraprak të Komuniteteve Europiane që i përkasin Programit të Shtatë Kuadër të KE-së;

- shuma e vlerësuar e kontributeve që rrjedh nga projektbuxheti paraprak, që i përket pjesëmarrjes së Shqipërisë në programin e Shtatë Kuadër të KE-së në pajtim me paragrafët e mësipërm 1, 2, 3 dhe 4.

Menjëherë pas miratimit të buxhetit të përgjithshëm, Komisioni i komunikon Shqipërisë, në deklarimin e shpenzimeve që i përket pjesëmarrjes së Shqipërisë, shumat përfundimtare që përmenden në nënparagrafin e parë.

II. Pagesa e kontributit financiar të Shqipërisë

1. Komisioni, jo më vonë se 30 janari ose 15 qershori i çdo viti financiar, bën apel për fonde për Shqipërinë që i përkasin kontributit të saj në bazë të këtij Memorandumi mirëkuptimi.

2. Këto apele për fonde kërkojnë, përkatësisht, pagesën:

- e gjashtë të dymbëdhjetat e kontributit të Shqipërisë jo më vonë se 15 marsi; dhe

- e gjashtë të dymbëdhjetat e kontributit të Shqipërisë jo më vonë se 20 korriku.

Megjithatë, gjashtë të dymbëdhjetat që duhet të paguhen jo më vonë se 15 marsi llogariten mbi bazën e shumës së caktuar në deklarimin e të ardhurave në projektbuxhetin paraprak: ligjërimi i shumës së paguar në këtë mënyrë bëhet me pagesën e gjashtë të dymbëdhjetave jo më vonë se 20 korriku.

Për vitin e parë të zbatimit të këtij Memorandumi mirëkuptimi, Komisioni do të bëjë apelin e parë për fonde me efekt prapaveprues, brenda 30 ditëve nga nënshkrimi. Nëse ky apel bëhet pas 15 qershorit, ai do kërkojë pagesën e dymbëdhjetë të dymbëdhjetave të kontributit të Shqipërisë brenda 30 ditëve, të llogaritur mbi bazën e shumës së caktuar në deklarimin e të ardhurave të buxhetit.

3. Në vitin e fundit të Programit të Shtatë Kuadër të KE-së, shuma e plotë e kontributit shqiptar paguhet jo më vonë se 20 korriku.

4. Kontributi i Shqipërisë shprehet dhe paguhet në euro.

5. Pagesa nga Shqipëria kreditohet në programet e Komunitetit si hyrje në buxhet të caktuar në zërin përkatës të buxhetit në deklarimin e të ardhurave të buxhetit të përgjithshëm të Komuniteteve Europiane. Rregullorja financiare e zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane zbatohet për menaxhimin e llogaritjeve.

6. Shqipëria do të paguajë kontributin e saj në bazë të këtij Memorandumi mirëkuptimi sipas përcaktimit në pikën II, 2 të aneksit II.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit shkakton pagesën e kamatëvonesave nga Shqipëria për shumën e prapambetur nga data e kërkueshme. Interesi për shumat e papaguara në datën e kërkueshme është interesi që zbatohet nga Banka Qendrore Europiane në operacionet e saj principale të rifinancimit, siç publikohet në serinë C të Gazetës Zyrtare të Bashkimit Europian, që është në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin bie data e kërkueshme, duke u shtuar me tri e gjysmë pikë përqindjeje.

Në rastin kur vonesa në pagesën e kontributit është e tillë që ajo mund të rrezikojë në mënyrë të konsiderueshme zbatimin dhe menaxhimin e programeve, pjesëmarrja e Shqipërisë në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së do të pezullohet nga Komisioni pas mungesës së pagesës 20 ditë pune pas një letre zyrtare kujtese, pa cenuar detyrimet e komunitetit në bazë të marrëveshjeve të grantit dhe/ose kontratave të lidhura që kanë të bëjnë me zbatimin e veprimeve të përzgjedhura jo të drejtpërdrejta.

7. Jo më vonë se 31 maji i vitit pas një viti financiar, deklarimi i llogaritjeve për Programin e Shtatë Kuadër të KE-së për atë vit financiar, përgatitet dhe i transmetohet Shqipërisë për informacion, sipas formatit të llogarisë së të ardhurave dhe shpenzimeve të Komisionit.

8. Komisioni, në momentin e mbylljes së llogarive në lidhje me çdo vit financiar, brenda kuadrit të krijimit të llogarisë së të ardhurave dhe shpenzimeve, procedon me ligjërimin e llogarive në lidhje me pjesëmarrjen e Shqipërisë.

Ky ligjërim merr parasysh modifikimet që kanë ndodhur, me transfertë, anulimet, mbartjet, zhvendosjet ose nëpërmjet buxheteve suplementare dhe amenduese gjatë vitit financiar.

Ky ligjërim kryhet në momentin e pagesës së dytë për vitin tjetër financiar. Ligjërimi tjetër kryhet çdo vit deri në korrik 2016.

ANEKSI III
KONTROLLI FINANCIAR, RIKUPERIMI DHE MASA TË TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

I. Kontrollet dhe masat kundër mashtrimit nga komuniteti

1. Në pajtim me Rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) nr.1605/2002 të datës 25 qershor 2002 mbi Rregulloren Financiare që zbatohet për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane[9], Rregulloren e Komisionit nr.2342/2002 e datës 23 dhjetor 2002 që cakton rregulla të detajuara për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC, Euratom) nr.1605/2002 mbi Rregulloren financiare të zbatueshme në buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane[10] dhe çdo amendim i ardhshëm (këtu quhet "Rregullore financiare"), Rregulloren e Këshillit (EC, Euratom) nr.2988/95 të 18 dhjetorit 1995 për mbrojtjen e interesave financiare[11] të Komuniteteve Europiane dhe me rregullat e tjera të referuara në këtë Memorandum mirëkuptimi, marrëveshjet e grantit dhe/ose kontratat e lidhura me përfitues të programeve të ngritura në Shqipëri, parashikojnë që auditimet financiare dhe të tjera të kryhen në çdo kohë në ambientet e përfituesve dhe të nënkontraktorëve të tyre nga agjentet e Komisionit ose persona të tjerë të autorizuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe personat e tjerë të autorizuar nga Komisioni kanë të drejtën e përshtatshme për të hyrë në kantiere, vende pune dhe dokumente dhe tek i gjithë informacioni i kërkuar me qëllim që të kryhen këto auditime, duke përfshirë formën elektronike. Kjo e drejtë hyrjeje thuhet shprehimisht në marrëveshjen e grantit dhe/ose kontratat e lidhura për të zbatuar instrumentet e referuara në këtë Memorandum mirëkuptimi. Gjykata Europiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta si Komisioni.

3. Në bazë të këtij Memorandumi mirëkuptimi, Komisioni, duke përfshirë OLAF-in, është i autorizuar të kryejë kontrolle dhe inspektime në vend në territorin e Shqipërisë, në pajtim me dispozitat procedurale të Rregullores së Këshillit (Euratom, EC) nr.2185/96 të datës 11 nëntor 1996[12] me qëllim që të mbrohen interesat financiare të Komuniteteve Europiane kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera, dhe në pajtim me Rregulloren (EC) nr.1073/1999 të Parlamentit Europian dhe Këshillit në lidhje me hetimet e zhvilluara nga Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF)[13].

- Këto kontrolle dhe inspektime përgatiten dhe zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente të caktuara nga Shqipëria, që njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që ato të japin të gjithë ndihmën e nevojshme.

Nëse autoritetet shqiptare të interesuara dëshirojnë, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen së bashku me to.

Nëse pjesëmarrësit në programe kundërshtojnë kontrollin ose inspektimin në vend, autoritetet shqiptare, duke vepruar në pajtim me rregullat e brendshme, u japin inspektorëve të Komisionit, duke përfshirë OLAF-in, atë asistencë që atyre u duhet për t'u dhënë mundësi të përmbushin detyrën e tyre në kryerjen e kontrollit dhe inspektimit në vend.

Komisioni, duke përfshirë OLAF-in, u raporton sa më shpejt të jetë e mundur autoriteteve shqiptare për çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi që ka ardhur në vëmendje të tij gjatë ushtrimit të kontrollit ose inspektimit në vend. Sidoqoftë, Komisionit, duke përfshirë OLAF-in, i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

II. Informim dhe konsultim

1. Për qëllimet e zbatimit të përshtatshëm të këtij aneksi, Autoritetet Kompetente Shqiptare dhe komunitare shkëmbejnë rregullisht informacion dhe, me kërkesë të një Pale, zhvillojnë konsultime.

2. Autoritetet Kompetente Shqiptare informojnë Komisionin pa vonesë për çdo parregullsi ose dyshim në lidhje me përfundimin ose zbatimin e marrëveshjeve të grantit dhe/kontratave të përfunduara në bazë të këtij Memorandumi mirëkuptimi dhe zbatimin e marrëveshjeve të grantit dhe/ose kontratave të përfunduara në zbatim të instrumenteve të përmendura në këtë Memorandum mirëkuptimi.

III. Masat administrative dhe gjobat

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal të Shqipërisë, masat administrative dhe gjobat mund të vendosen nga Komisioni në pajtim me Rregulloren Financiare të Komuniteteve.

Masat e duhura merren nga Shqipëria edhe për të parandaluar parregullsitë dhe mashtrimin dhe duhet të ndërmerren hapat e duhur për të rikuperuar fondet e humbura, të paguara gabimisht ose të përdorura në mënyrë të pasaktë.

---

[9]GZ L248, datë 16/9/2002, f.1, modifikuar me Rregulloren (EC) nr.1995/2006, datë 13 dhjetor 2006, (GZ L390, datë 30/12/2006, f. 1).

[10]GZL357 datë 31/12/2002, modifikuar së fundi me Rregulloren (EC, Euratom) nr.478/2007, datë 23 prill 2007.

[11]GZ L312 - date 23/12/1995, f.1.

[12]GZ L292, datë 15/11/1996. f.2.

[13]GZ L136, datë 31/05/1999, f.1.

Shqipëria merr, gjithashtu edhe masat e nevojshme për të siguruar që Komisionit Europian, OLAF-it dhe Gjykatës së Auditëve të Komuniteteve Europiane t'i jepen kompetencat për të kryer kontrollin financiar dhe auditimet nga ose nën autoritetin e tyre, në lidhje me përfituesit ose kontraktorët e themeluar në Shqipëri.

IV. Rikuperimi

Vendimet e marra nga Komisioni brenda objektit të këtij Memorandumi mirëkuptimi që caktojnë detyrime financiare mbi personat e ndryshëm nga Shtetet janë të ekzekutueshëm në Shqipëri. Ekzekutimi rregullohet nga rregullat shqiptare të procedurës civile. Urdhri për ekzekutimin e tij i bashkëngjitet vendimit, pa formalitete të tjera përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit nga autoriteti kombëtar që qeveria e Shqipërisë cakton për këtë qëllim dhe ia bën të ditur Komisionit. Pasi këto formalitete të jenë përmbushur me kërkesë të Komisionit, ky i fundit mund të vazhdojë me ekzekutimin në pajtim me ligjin e brendshëm, duke ia paraqitur çështjen drejtpërdrejt autoritetit kompetent.

Ligjshmëria e vendimit të Komisionit i nënshtrohet kontrollit të Gjykatës së Drejtësisë së Komuniteteve Europiane.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një marrëveshje granti dhe/ose kontrate brenda objektit të këtij Memorandumi mirëkuptimi janë të ekzekutueshme sipas të njëjtave terma.

V. Komunikimi i drejtpërdrejtë

Komisioni komunikon drejtpërdrejt me çdo pjesëmarrës në Programin e Shtatë Kuadër të KE-së të themeluar në Shqipëri dhe me nënkontraktorët e tyre. Ata mund t'i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit të gjithë informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin që atyre u kërkohet të paraqesin mbi bazën e instrumenteve të referuara në këtë Memorandum mirëkuptimi dhe të marrëveshjeve të grantit dhe/ose kontratave të lidhura për zbatimin e tyre.

LIGJ
Nr.9867, datë 31.1.2008

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR TREGTIMIN NDËRKOMBËTAR TË LLOJEVE TË RREZIKUARA TË FAUNËS DHE TË FLORËS SË EGËR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat për zbatimin e dispozitave të konventës "Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe të faunës së egër", në mënyrë që tregtia e tyre ndërkombëtare të mos ua rrezikojë mbijetesën dhe të shmangë keqtrajtimet e tyre gjatë tregtimit ndërkombëtar.

Neni 2
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Konventa” është konventa “Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe të faunës së egër” (CITES), ku Republika e Shqipërisë ka aderuar me ligjin nr.9021, datë 6.3. 2003.

2. “Konferenca e palëve” është konferenca e vendeve palë në konventë.

3. “Anekset” janë listat me llojet e florës dhe faunës së egër, që mbrohen nga ky ligj gjatë tregtimit të tyre ndërkombëtar, të cilat janë miratuar me ligjin nr.9021, datë 6.3.2003 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën “Për tregtinë ndërkombëtare të llojeve të rrezikuara të florës dhe të faunës së egër” (CITES)”. Konkretisht:

a) Aneksi 1, ku janë të listuara llojet e kërcënuara me zhdukje, tregtimi i të cilave lejohet vetëm në rrethana të jashtëzakonshme;

b) Aneksi 2, ku janë të listuara llojet jo detyrimisht të rrezikuara me zhdukje, por për të cilat duhet kontrolluar tregtimi, për të garantuar mbijetesën e tyre;

c) Aneksi 3, ku janë të listuara llojet, që mbrohen të paktën nga një shtet, i cili u ka kërkuar shteteve të tjera palë asistencë në kontrollin e tregtimit të tyre.

4. “Lista vendase” është lista e llojeve të veçanta, vendase, të florës dhe faunës, që besohet se janë të rrezikuara dhe meritojnë mbrojtje, sepse nuk janë përfshirë ende në anekset e konventës. Kjo listë miratohet me urdhër të ministrit.

5. “Rezolutat e konferencave të palëve” janë marrëveshjet e shteteve palë të konventës, që kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të konventës.

6. “Vendimet e konferencave të palëve” janë marrëveshjet ndërmjet shteteve palë të konventës, që përmbajnë, kryesisht, udhëzime për një komitet të veçantë, për palët ose për sekretariatin.

7. “Vendi i origjinës” është vendi ku një individ është marrë nga gjendja e egër, ku është lindur, është shumuar në gjendje jo të lirë, është riprodhuar artificialisht ose ka hyrë nga deti.

8. “Hyrje nga deti” është formë e veçantë e sigurimit të individëve të llojeve, që merren nga një mjedis detar (përfshirë hapësirën ajrore mbi det, shtratin e detit dhe nëntokën e tij), i cili nuk është në juridiksionin e ndonjë shteti.

9. “Individ”, në këtë rast nënkupton:

a) çdo kafshë ose bimë, të gjallë ose të pajetë, të një lloji, të përfshirë në anekse;

b) çdo pjesë ose derivat të një individi, të një lloji të faunës ose të florës, të përfshirë në anekse e në listën vendase, me kusht që të figurojë në një dokument shoqërues, të jetë shkruar në paketim, në markë ose në etiketë.

10. “Zotërim dhe mbajtje në kontroll” është gjendja e robërisë së individëve të llojeve që zotërohen dhe janë nën kontrollin e personave fizikë e juridikë.

11. “Tregtim ndërkombëtar” është çdo eksport, import, rieksport ose hyrja nga deti e individëve të llojeve të faunës ose të florës, që mbrohen nga ky ligj.

12. “Tregti e brendshme” është çdo veprim tregtar, përfshirë shitjen, blerjen, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

13. “Shitje” është çdo formë shitjeje dhe shkëmbimi.

14. “Qendër shpëtimi” është një qendër për shpëtimin e individëve, që krijohet dhe funksionon sipas dispozitave të këtij ligji.

15. “Shumim në gjendje jo të lirë”, u referohet vetëm pasardhësve, përfshirë vezët, të lindurit ose të prodhuarit në një mjedis të kontrolluar, nga prindër, që kanë transmetuar gametet e tyre në këtë mjedis.

16. “Shtim artificial”, u referohet vetëm bimëve të rritura nga njeriu nga fara, nga prerjet, indet, sporet apo shumimet e tjera, në kushte të kontrolluara.

17. “Leje” është dokumenti zyrtar, që autorizon importin, eksportin, rieksportin ose hyrjen nga deti të individëve, të llojeve të listuara në anekse.

18. “Ministër” është ministri që drejton ministrinë përgjegjëse për florën dhe faunën e egër.

19. “Ministria” është ministria përgjegjëse për florën dhe faunën e egër.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për llojet e faunës dhe të florës, të listuara në anekset e konventës, si dhe për ato të listuara në listën vendase, ku përfshihen llojet e faunës dhe të florës vendase, të cilat miratohen me urdhër të ministrit. Me sugjerimin e instituteve kërkimore-shkencore përkatëse, ministri miraton shtimin ose heqjen e një lloji të caktuar nga lista vendase.

2. Për individë të një lloji, të përfshirë më vonë në njërën nga tri anekset e konventës, personi fizik apo juridik, që e ka në zotërim ose në kontroll, zbaton detyrimet, që burojnë nga përfshirja, 6 muaj pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, por jo më vonë se një vit.

3. Importi, eksporti, tranzitimi, rieksporti i llojeve të florës dhe të faunës së egër, që nuk janë të listuara në anekset e përmendura në pikën 3 të nenit 2 të këtij ligji, nuk pajisen me leje, por i nënshtrohen kontrollit të zakonshëm doganor.

Neni 4
Ndalime

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, janë të ndaluara:

a) zotërimi dhe mbajtja nën kontroll, për qëllime tregtimi, e individëve të llojeve të listuara në anekse;

b) tregtimi, ekspozimi dhe ofertimi për shitje ose bërja të ditur publikut e individëve të llojeve të listuara në anekse, të cilat janë importuar;

c) tregtimi ndërkombëtar i individëve të llojeve të listuara në anekse me mënyra, forma e mjete, që nuk garantojnë trajtimin e duhur shëndetësor të tyre.

Neni 5
Prova e zotërimit

Përgjegjësia për të provuar zotërimin e një individi të një lloji të përfshirë në anekse bie mbi zotëruesin e këtij individi.

KREU II
INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE

Neni 6
Autoriteti menaxhues

1. Ministria është institucioni qendror përgjegjës për zbatimin e kërkesave të konventës, të dispozitave të këtij ligji e të akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Drejtoria përkatëse, në përbërje të strukturës së ministrisë, për zbatimin e konventës dhe të pikës fokale kombëtare, ka këto detyra kryesore:

a) përgatit lejet, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të cilat nënshkruhen nga persona të autorizuar nga ministri;

b) harton kushtet e kërkesat e veçanta, që i bashkëlidhen lejes që miratohet;

c) administron të dhënat e tregut ndërkombëtar të individëve;

ç) përgatit raportin vjetor, që i paraqitet sekretariatit të konventës, sipas formatit të dërguar prej tij, deri më 31 tetor të vitit pasardhës së vitit, të cilit i referohet raporti;

d) përgatit raportin 2-vjeçar për plotësimin e masave ligjore, rregulluese dhe administrative në këtë fushë, që i paraqitet sekretariatit të konventës;

dh) sugjeron krijimin e një ose më shumë qendrave të shpëtimit për individë të gjallë, të sekuestruar dhe të konfiskuar, në këshillim me autoritetin shkencor;

e) komunikon me sekretariatin dhe vende të tjera, palë në konventë, për çështje shkencore, administrative dhe zbatuese;

ë) bashkëpunon me organe të tjera shtetërore për zbatimin e legjislacionit vendas për ruajtjen e llojeve;

f) kontrollon tregun vendas, zotërimin dhe transportin e individëve të çdo lloj kafshe ose bime të listuar në anekse për qëllime tregtimi;

g) përgatit formatin e regjistrave që kërkohen nga ky ligj, të cilat miratohen nga ministri;

gj) administron regjistrat kombëtarë të llojeve të faunës e të florës, të specialistëve dhe të

subjekteve të regjistruara;

h) përgatit kuotat vjetore të eksportit të individëve, të cilat miratohen nga ministri;

i) përgatit marrëveshje dy ose shumëpalëshe me vende, që krijojnë dhe zbatojnë një program aktiv e të përshtatshëm për ruajtjen e llojeve të rrezikuara dhe të kërcënuara, të cilat nënshkruhen nga ministri;

j) monitoron lejet e eksportit, të lëshuara për individë të llojeve të listuara në aneksin 2, si dhe eksportet aktuale të këtyre llojeve, si dhe i sugjeron ministrit masat e përshtatshme që duhen ndërmarrë për të kufizuar lejet e eksportit, kur një gjë të tillë e kërkon gjendja e popullatës së atij lloji;

k) ndërhyn menjëherë për të parandaluar një rrezik të rëndë në mirëqenien e llojeve të rimëkëmbura.

Neni 7
Autoriteti shkencor

1. Në këshillim me universitetet përkatëse, ministri përcakton institucionet kërkimore-shkencore për faunën dhe për florën, që do të njihen si autoriteti shkencor këshillues për zbatimin e konventës, të dispozitave të këtij ligji dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

2. Autoriteti shkencor këshillon autoritetin menaxhues nëse:

a) një kërkesë për një eksport individi, të llojeve të listuara në anekset 1 apo 2, dëmton ose jo mbijetesën e llojit;

b) një kërkesë për një import individi, të llojeve të listuara në aneksin 1, dëmton ose jo mbijetesën e llojit;

c) marrësi i individëve plotëson kushtet për t'i mbajtur dhe për t'u kujdesur për to;

ç) individët e konfiskuar duhet të dërgohen për rehabilitim në qendrën e shpëtimit apo duhen asgjësuar.

3. Autoriteti shkencor, gjithashtu, kryen çdo detyrë, që i rekomandohet nga rezolutat e konferencës së palëve, si dhe sugjeron masat e zgjidhjet për çështje, që ai i vlerëson të rëndësishme në fushën e mbrojtjes së llojeve.

Neni 8
Specialistët e certifikuar

1. Punonjësit shkencorë të instituteve kërkimore-shkencore, të shpallura si autoritet shkencor, specialistët e qendrave të shpëtimit dhe specialistë të tjerë të faunës e të florës pajisen me certifikatë dhe shpallen specialistë të certifikuar.

2. Specialistët e certifikuar japin mendim, përgatisin ekspertiza, këshillojnë autoritetin menaxhues, thirren nga organet doganore e nga gjykata, në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

3. Specialistët e certifikuar shpallen nga ministri, duke u pajisur me certifikatë, në përputhje me udhëzimin për rregullat dhe procedurat e certifikimit të specialistëve, të miratuar prej tij, ku jepen me hollësi kërkesat e testit për specialistët e faunës e të florës, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e miratimit të kërkesës, si dhe tarifa e shërbimit për t'u pajisur me certifikatë.

4. Autoriteti menaxhues administron regjistrin e specialistëve të certifikuar, i cili shpallet në faqen e internetit të ministrisë.

Neni 9
Organet kontrolluese

Policia Pyjore dhe Inspektorati i Peshkimit për llojet e faunës e florës ujore, të listuara në anekse dhe në listën vendase, janë organet kontrolluese për zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Neni 10
Doganat

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me strukturat e veta në zonat doganore, është organi që realizon zbatimin e dispozitave të këtij ligji e të konventës, nëpërmjet kontrollit doganor mbi importet, eksportet rieksportet e tranzitimet e individëve të llojeve të faunës e florës, të listuara në anekse e në listën vendase.

KREU III
REGJISTRIMI DHE LEJET

Neni 11
Regjistrimi

1. Personat fizikë e juridikë, që dëshirojnë të tregtojnë, të importojnë, të eksportojnë, të rieksportojnë individë, të llojeve të listuara në anekset e konventës e në listën vendase, të prodhojnë kafshë të shumuara në gjendje jo të lirë, të fusin nga deti dhe të shtojnë artificialisht bimë për tregtim ndërkombëtar, duhet të regjistrohen pranë autoritetit menaxhues.

2. Edhe institutet kërkimore-shkencore, publike dhe private, që studiojnë llojet e faunës e të florës, të listuara në anekse, kanë detyrimin të regjistrohen pranë autoritetit menaxhues.

3. Personat fizikë dhe juridikë dhe institutet kërkimore-shkencore, publike dhe private, që regjistrohen, shënohen në regjistrin e subjekteve, i cili administrohet nga autoriteti menaxhues.

4. Rregullat e hollësishme për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e kërkesës për regjistrim përcaktohen në rregulloren që miratohet nga ministri.

Neni 12
Procedurat e regjistrimit

Për t'u regjistruar, personat fizikë apo juridikë hartojnë dhe dorëzojnë në ministri kërkesën për regjistrim dhe dokumentet shoqëruese, si më poshtë:

a) kopje të vendimit të gjykatës, që e ka regjistruar si person fizik apo juridik, për të ushtruar veprimtarinë, për të cilën regjistrohet, ose kopje të regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, kur kërkuesi aplikon me dokumente të miratuara nga kjo qendër;

b) deklarim personal, me përshkrim të hollësishëm të veprimtarisë që kërkojnë të kryejnë, sipas formularëve tip të konventës.

Neni 13
Lejet

1. Eksporti, importi dhe rieksporti i çdo individi të llojeve, të përfshira në anekse dhe në listën vendase, kryhen vetëm pasi personi fizik apo juridik pajiset me lejen përkatëse, të cilën e paraqet në organet doganore.

2. Personi fizik apo juridik nuk pajiset me leje për:

a) tranzitimin e individëve të llojeve të listuara në anekse;

b) importin dhe eksportin e individëve të llojeve të listuara në anekset 1 e 2, të cilët janë personalë e që mbahen në shtëpi dhe nuk përdoren për qëllime tregtare, sipas deklarimit të personit, të përcaktuar në nenin 16 të këtij ligji;

c) importin dhe eksportin e individëve të llojeve të listuara në anekse, në raste të huave jotregtare, të donacioneve dhe të shkëmbimeve ndërmjet institucioneve shkencore dhe shkencëtarëve, që janë regjistruar në regjistrin kombëtar.

3. Individët e llojeve të listuara në aneksin 1, që kanë lindur dhe janë shumuar në gjendje jo të lirë ose që janë shtuar artificialisht, trajtohen në përputhje me dispozitat që zbatohen për individë të llojeve të listuara në aneksin 2.

4. Autoriteti menaxhues njofton rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për lejet që jep, formatin e tyre, emrat e subjekteve të pajisura me leje, si dhe rastet e revokimit të lejeve.

Neni 14
Kushtet për marrjen e lejes për import

1. Lejet për importimin e individëve të llojeve të listuara në anekset 1 e 2 lëshohen nga autoriteti shkencor kur:

a) sigurohet se importimi nuk dëmton mbijetesën e llojeve përkatëse;

b) është shprehur se hyrja nuk do të ketë efekt të dëmshëm në statusin e ruajtjes së llojit dhe në sipërfaqen e zënë nga popullatat e tij;

c) është i bindur se strehimi i parashikuar për një individ të gjallë në vendin e destinacionit plotëson të gjitha kushtet për t'u përkujdesur dhe për ta ruajtur këtë individ;

ç) është i bindur se individi nuk do të përdoret për qëllime tregtimi;

d) ai dhe autoriteti menaxhues binden se individi do të përgatitet dhe do të transportohet në mënyrë të tillë, që të minimizojë rrezikun e plagosjes, të dëmtimit të shëndetit dhe të trajtimit mizor;

dh) bindet se individi i caktuar nuk është përfituar në kundërshtim me këtë ligj, përfshirë edhe ligjin e vendit nga importohet.

2. Leja e importit, e hyrjes nga deti, jepet për individë të llojeve të listuara në anekset 1 e 2 vetëm kur autoriteti shkencor dhe autoriteti menaxhues binden se importi nuk ka qëllim kryesor tregtimin e këtij individi.

Neni 15

Kushtet për marrjen e lejes për eksport dhe rieksport

Lejet për eksportimin dhe rieksportimin e individëve të llojeve të listuara në anekse lëshohen vetëm kur autoriteti shkencor:

a) ka deklaruar me shkrim se kapja dhe mbajtja e individëve të llojeve në gjendje të egër dhe eksporti i tyre nuk ka efekt dëmtues në statusin e ruajtjes së llojit dhe në sipërfaqen e zënë nga popullatat e tij;

b) bindet se individët e llojeve, që nuk janë të listuara në aneksin 1, nuk do të përdoren për qëllime tregtimi;

c) së bashku me autoritetin menaxhues binden se individët kanë hyrë në territorin e vendit në mënyrë të ligjshme përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe të konventës, ose kanë hyrë në përputhje me dispozitat e këtij ligji;

ç) bindet se individi, që do të rieksportohet, është importuar në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të konventës.

Neni 16

Kushte të përbashkëta për marrjen e lejes së importit e të eksportit

1. Individë të llojeve të faunës, të listuara në anekset 1 ose 2, të cilët janë shumuar në gjendje jo të lirë, mund të tregtohen vetëm nëse veprimtaria për shumimin e tyre është e regjistruar nga autoriteti menaxhues dhe nëse individët janë matrikulluar në mënyrë që të jetë i pamundur ndryshimi apo modifikimi i tyre nga persona të tretë.

2. Autoriteti menaxhues, pas këshillimeve me autoritetin shkencor bindet se për ruajtjen e llojit nuk ka faktorë të tjerë, që ndikojnë negativisht në lëshimin e lejes.

3. Autoriteti menaxhues bindet se çdo dërgesë e llojeve të gjalla, që importohet, eksportohet ose rieksportohet, është në përputhje me udhëzimet për transportin e kafshëve të gjalla, publikuar nga sekretariati i konventës. Në rast transporti ajror, bindet se çdo dërgesë e llojeve të gjalla është në përputhje me botimin e fundit të rregulloreve të shoqatës ndërkombëtare të transportit ajror për kafshët e gjalla dhe se dërgesa do të përgatitet dhe do të udhëtojë në mënyrë të tillë, që minimizon rrezikun e plagosjes, të dëmtimit të shëndetit ose trajtimin e papranueshëm të tyre.

4. Personi fizik apo juridik kërkon dhe pajiset me leje edhe kur do të importojë apo eksportojë një individ të vetëm.

5. Leja nuk mund t'i transferohet një personi tjetër, të ndryshëm nga ai, në emër të të cilit është lëshuar.

Neni 17

Aplikimi

1. Çdo aplikant, që kërkon një leje për llojet e listuara në anekse, paraqet një aplikim me shkrim në ministri, së bashku me kërkesën dhe dokumentet shoqëruese të saj.

2. Kërkesa për një leje importi për individë të llojeve të listuara në anekse përmban:

a) adresën e dërguesit dhe të marrësit;

b) përshkrimin e llojeve, statusin e mbrojtjes dhe sasinë e individëve, që kërkohen të importohen;

c) datën dhe kohën e pritshme të kalimit të kufirit dhe zonën doganore të kalimit;

ç) përshkrimin e kushteve të transportit, të cilat zbatohen për individët e gjallë;

d) përshkrimin e kushteve, ku individët e gjallë të importuar do të vendosen dhe do të qëndrojnë.

3. Kërkesa për leje importi shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) kopje të lejes së eksportit ose të rieksportit, të lëshuar paraprakisht nga autoriteti menaxhues i shtetit eksportues;

b) kopje të vendimit të gjykatës, që ka regjistruar personin fizik apo juridik për të kryer këtë veprimtari;

c) certifikatë mjekësore për individë të gjallë të llojeve bimore e shtazore;

ç) fotokopje të dokumentit të identitetit të kërkuesit;

d) fotokopje të dokumentit të regjistrimit të personit në regjistrin e autoritetit menaxhues;

dh) një deklarim me shkrim të personit se individi importohet për qëllime tregtimi ose për përdorim vetjak.

4. Kërkesa për leje eksporti shoqërohet me dokumentet e mëposhtme:

a) dokumentin që vërteton origjinën e individit;

b) fotokopjen e dokumentit të regjistrimit të personit në regjistrin e autoritetit menaxhues;

c) fotokopjen e dokumentit të identitetit të kërkuesit;

ç) dokumentin që provon se shteti pritës është dakord me importimin;

d) kur leja kërkohet për një individ të shtuar në gjendje jo të lirë, edhe një përshkrim të shkurtër të llojit bimor ose shtazor, që tregon origjinën e individit në fjalë dhe numrin e gjeneratës gjenetike të tij;

dh) deklarimin me shkrim të personit, që vërteton se individi eksportohet për qëllime tregtimi ose për përdorim vetjak.

5. Kur autoriteti menaxhues, në bashkëpunim me autoritetin shkencor, vëren mangësi në dokumentet e paraqitura, i kërkon aplikantit dokumente shtesë.

Neni 18

Kushtet e lejes

1. Leja shoqërohet me kushte e kërkesa të veçanta, të detyrueshme, të cilat mbrojnë individët nga keqtrajtimet e dëmtimet gjatë importit, eksportit dhe rieksportit.

2. Kushtet e lejes hartohen në përputhje me kërkesat konkrete të konventës, të rezolutave e të vendimeve të konferencave të palëve dhe miratohen bashkë me lejen, si pjesë të saj.

Neni 19

Afatet e miratimit

1. Brenda tri ditëve pune pas marrjes së aplikimit për lëshimin e një lejeje importi ose eksporti për individët e llojeve të listuara në anekse, autoriteti menaxhues kërkon mendim nga autoriteti shkencor, i cili i përgjigjet me shkrim brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së saj. Ky afat është i vlefshëm edhe kur nevojitet një ekzaminim në vend, i cili kryhet nga specialistë të certifikuar.

2. Leja lëshohet brenda 15 ditëve pune pas datës së dorëzimit të aplikimit.

Neni 20

Vlefshmëria

1. Lejet e eksportit dhe të rieksportit janë të vlefshme për një periudhë 6-mujore nga data e lëshimit.

2. Leja e importit për individë të llojeve të përfshira në ankeset 1 e 2 është e vlefshme për një periudhë 12-mujore nga data e lëshimit.

Neni 21

Revokimi

Ministri revokon, në çdo kohë, çdo leje të lëshuar, kur provohet se është lëshuar si rezultat i deklaratave të pavërteta ose me qëllim mashtrues të aplikantit.

Neni 22

Pavlefshmëria

Leja vlerësohet e pavlefshme kur:

a) autoriteti menaxhues zbulon se është lëshuar në kundërshtim me legjislacionin e një vendi të huaj, me konventën ose me rezolutat dhe vendimet e konferencës së palëve;

b) autoriteti menaxhues provon se mbajtësi i lejes nuk ka përmbushur ndonjërën nga kushtet e përcaktuara në leje ose certifikatë;

c) ka mbaruar afati i vlefshmërisë së saj;

ç) mbajtësi i lejes, person fizik, vdes, ose person juridik, pushon së ekzistuari.

Neni 23
Tarifat

1. Personat fizikë dhe juridikë që pajisen me leje, si dhe ata që regjistrohen, paguajnë një tarifë shërbimi, e cila derdhet në llogarinë e ministrisë përgjegjëse, në fillim të procedurës së aplikimit dhe është e pakthyeshme, pavarësisht nëse jepet apo jo leja ose regjistrimi.

2. Ministri miraton udhëzimin për caktimin e tarifave të shërbimit për pajisjen me leje dhe për regjistrim.

Neni 24
Formatimi

1. Organet shtetërore, personat fizikë e juridikë veprojnë me dokumentacion standard dhe të formatuar, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Ministri miraton:

a) formatin e kërkesës për regjistrim, si dhe formatin e kërkesës për t'u pajisur me leje;

b) formatin e lejeve për import e për eksport;

c) formatin e regjistrave, ku hidhen të dhënat nga personat fizikë e juridikë, të pajisur me leje;

ç) formatin e kërkesës për të dhënat, që raportojnë personat e regjistruar e të pajisur me leje;

d) formatin e regjistrit të ekspertëve të certifikuar.

3. Formatet hartohen në përputhje me modelet e parashikuara nga konventa e nga rezolutat e konferencave të palëve.

KREU IV
MONITORIMI

Neni 25
Monitorimi

1. Monitorimi i gjendjes së llojeve të listuara në anekse, i importit, eksportit, tranzitimit e i futjes nga deti të individëve të tyre, i veprimtarive të shtimit artificial të bimëve e të shumimit, në gjendje jo të lirë, të kafshëve, për qëllime tregtimi e importimi, është pjesë e programit të biomonitorimit, që hartohet e zbatohet nga ministria përgjegjëse dhe miratohet nga ministri.

2. Monitorimi i gjendjes së llojeve të listuara në anekse, i importit, eksportit, tranzitimit e i futjes nga deti të individëve të tyre, i veprimtarive të shtimit artificial të bimëve e të shumimit, në gjendje jo të lirë, të kafshëve, për qëllime tregtimi e importimi, ka të bëjë me:

a) përcaktimin e gjendjes së llojeve të listuara në anekse, në kohën e hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe përditësimin e të dhënave për gjendjen e këtyre llojeve çdo 3 vjet;

b) evidentimin, çdo vit, të kërkesave për import, eksport, futjen nga deti e për tregtim të individëve të llojeve të listuara në anekse, që kryhet nga autoriteti menaxhues;

c) identifikimin e veprimtarive, që synojnë shumimin, në gjendje jo të lirë, të kafshëve ose shtimin artificialisht të bimëve, me qëllim tregtimi e importimi, që kryhet nga autoriteti menaxhues;

ç) mbikëqyrjen e veprimtarisë së qendrave të shpëtimit, i cili kryhet nga personeli i qendrës;

d) mbikëqyrjen efektive nga autoriteti menaxhues, në bashkëpunim me Agjencinë e Mjedisit dhe të Pyjeve, për jo më pak se 5 vjet, të rimëkëmbjes së llojeve, ndaj të cilave nuk është e nevojshme marrja e masave, sipas parashikimeve të këtij ligji, sepse ato mund të dalin në anekse.

3. Për realizimin e synimeve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni autoriteti menaxhues, në bashkëpunim me autoritetin shkencor, me doganat e me Agjencinë e Mjedisit dhe të Pyjeve, ndërton dhe zbaton një sistem të detyrueshëm monitorimi, i cili miratohet nga ministri.

Neni 26
Të dhënat dhe raportimi

1. Personat e regjistruar pranë autoritetit menaxhues për tregtimin, shumimin, në gjendje jo të lirë, të kafshëve ose shtimin artificial të bimëve, për qëllime tregtimi e importimi, mbajnë të dhëna për to dhe për çdo transaksion që realizojnë me to në regjistrin e të dhënave.

2. Autoriteti menaxhues inspekton, në çdo kohë, mjediset ku kryhen veprimtaritë e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe verifikon të dhënat e shënuara në regjistër për personat e regjistruar.

3. Personat e regjistruar i raportojnë Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve të dhënat, që mbajnë në regjistër, brenda 20 ditëve nga data e kërkesës së kësaj agjencie.

KREU V
KONTROLLI DOGANOR

Neni 27
Zonat doganore

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave përcakton zonat doganore, ku lejohen eksportet dhe rieksportet e individëve të llojeve të listuara në anekse, si dhe importet, tranzitimet apo hyrjet nga deti të individëve të llojeve të faunës e të florës, të listuara në anekse.

Neni 28
Kontrolli

1. Autoritetet e doganave ushtrojnë kontrollin doganor për importet, eksportet dhe rieksportet e personave fizikë dhe juridikë, që synojnë të fusin ose të nxjerrin individë të llojeve të listuara në anekse, si dhe në listën vendase në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Organet doganore, në përputhje me legjislacionin doganor:

a) kontrollojnë nëse ngarkesa (dërgesa) shoqërohet me lejen dhe dokumentet përkatëse, siç parashikohen në nenet 14 deri në 16 të këtij ligji;

b) specialistët veterinarë dhe fitosanitarë, në përbërje të organit doganor, përcaktojnë, brenda një ore, nëse individët po transportohen, në përputhje me kërkesat e përshkruara në leje;

c) verifikojnë numrin faktik të individëve, në raport me atë të përcaktuar në lejet e importit, eksportit ose të rieksportit;

ç) brenda pesë ditëve dorëzojnë në ministri një kopje të lejeve të importit dhe të eksportit, të kontrolluara.

Neni 29
Masat

1. Autoritetet doganore, kur vërejnë shkelje të kërkesave të këtij ligji apo kur dyshojnë për shkelje të tilla, vendosin:

a) mospranimin e importimit apo të eksportimit dhe kthimin e ngarkesës e të mjetit në vendin e origjinës apo në vendin nga ka ardhur;

b) lajmërojnë menjëherë ministrinë, e cila dërgon inspektorët e autorizuar nga ministri për të zgjidhur çështjen dhe, kur verifikohet shkelje, sigurojnë vendosjen e individit në qendrat e shpëtimit.

2. Inspektorët dhe qendra e shpëtimit bashkëpunojnë me autoritetet doganore për zgjidhjen e çështjeve, sipas pikës 1 të këtij neni dhe për të marrë një vendim të bazuar ligjërisht.

Neni 30
Trajtimi në qendrën e shpëtimit

Individët e sekuestruar ose të konfiskuar, para se të lëshohen në jetën e egër, trajtohen paraprakisht në qendrën e shpëtimit. Krijimi dhe funksionimi i qendrës së shpëtimit bëhen me dispozita të veçanta ligjore.

Neni 31
Dispozita financiare

1. Shpenzimet e kryera nga institucionet buxhetore për zbatimin e dispozitave të këtij ligji përballohen nga buxheti i miratuar për këto institucione.

2. Tarifat dhe gjobat e paguara, sipas këtij ligji, derdhen në Buxhetin e Shtetit dhe trajtohen sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim.

3. Çdo kontribut vullnetar nga individë apo organizata për ruajtjen e jetës së egër trajtohen si të ardhura për institucionet ku ato krijohen.

KREU VI
SANKSIONET

Neni 32
Kundërvajtjet administrative

1. Kur shkeljet e përmendura më poshtë nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë:

a) importi, eksporti ose rieksporti i çdo individi të një lloji të listuar në anekse me leje false, të pavlefshme ose të ndryshuar pa miratimin e ministrit, nga 70 000 deri në 100 000 lekë;

b) zotërimi, ofrimi ose ekspozimi për shitje, si dhe reklamimi në publik i çdo individi të një lloji të listuar në anekse, nga 10 000 deri në 15 000 lekë;

c) mosregjistrimi i personave fizikë apo juridikë, sipas kërkesave të nenit 11 të këtij ligji, nga 10 000 deri në 15 000 lekë;

ç) refuzimi, kundërshtimi dhe pengimi i grupit të kontrollit apo i inspektorit të autorizuar në kryerjen e detyrave, nga 30 000 deri në 50 000 lekë;

d) ndryshimi, dëmtimi ose fshirja e vulës së autoritetit menaxhues, nga 10 000 deri në 15 000 lekë;

dh) deklarimi i rremë, në kundërshtim me nenin 16 të këtij ligji, nga 70 000 deri në 100 000 lekë;

e) deklarimi i rremë ose dhënia e informacioneve të rreme, për të siguruar një leje, nga 70 000 deri në 100 000 lekë.

ë) mosplotësimi i kërkesave e i kushteve të përcaktuara në leje, nga 10 000 deri në 15 000 lekë;

f) transporti i individëve të gjallë, në kundërshtim me kërkesat e pikës 3 të nenit 15 të këtij ligji, nga 10 000 deri në 15 000 lekë.

2. Kur kundërvajtja përsëritet brenda 1 viti kalendarik, gjoba vendoset sa dyfishi i gjobës së përcaktuar për atë shkelje.

3. Për shkelje të rënda, krahas gjobës, mund të vendoset edhe heqja e lejes.

Neni 33
Kontrolli

1. Kur inspektori i Policisë Pyjore ka prova të mjaftueshme të një kundërvajtjeje, në zbatim të funksioneve dhe kompetencave të përcaktuara në ligjin nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, ndalon personin e dyshimtë dhe konfiskon çdo objekt, që lidhet me kundërvajtjen e dyshuar.

2. Inspektori i Policisë Pyjore:

a) hyn dhe ushtron kontrolle në territore, ndërtesa e mjete transporti, për të cilat ai dyshon se mbahet një individ në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

b) ekzaminon individin e transportuar, të marrë ose të tregtuar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;

c) ekzaminon çdo të dhënë, që është mbajtur për individët, objekt kundërvajtjeje;

ç) konfiskon individin, si dhe çdo send, që e gjykon se është objekt i një kundërvajtjeje ose mjet, me të cilin është kryer kundërvajtja.

3. Shpenzimet e bëra si rezultat i ndalimit, përfshirë shpenzimet e kujdestarisë, të transportit dhe të asgjësimit të individëve ose të mirëmbajtjes së kafshëve të gjalla dhe të bimëve, gjatë kohës së ndalimit, mbulohen nga kundërvajtësi. Urdhri i ministrit për pagimin e tyre përbën titull ekzekutiv.

Neni 34

Sekuestrimi

1. Në të gjitha rastet, individët, që janë objekt i një kundërvajtjeje, sekuestrohen.

2. Kur një person është dënuar për një kundërvajtje, sipas këtij ligji, atëherë sekuestrohet, gjithashtu, çdo kafaz, kontenier, varkë, aeroplan, makinë ose artikuj dhe pajisje të tjera, me anë të të cilave është kryer kundërvajtja.

3. Individët e sekuestruar, sipas dispozitave të këtij ligji, mbeten pronë e autoritetit menaxhues, i cili, në këshillim me autoritetin shkencor dhe në përputhje me kriteret e miratuara në udhëzimin e ministrit, vendos dërgimin e tyre në qendrën e shpëtimit ose asgjësimin e tyre përfundimtar.

Neni 35
Dokumentimi

1. Çdo shkelje e dispozitave të këtij ligji, e cila vërtetohet e më pas ndëshkohet, duhet të pasqyrohet në dokumentet e standardizuara e të miratuara nga ministri, të tilla si procesverbale e fletëgjoba.

2. Dokumentet plotësohen nga inspektori kontrollues, i cili, kur vëren shkelje të këtyre dispozitave, harton procesverbalin, që duhet të nënshkruhet nga hartuesi, i proceduari dhe dëshmitarët e pranishëm dhe, kur nuk ka të tillë, procesverbali është i vlefshëm vetëm me nënshkrimin e proceduesit.

3. Të drejtën e vendosjes së gjobës për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji, e kanë inspektori i Policisë Pyjore, inspektori i peshkimit ose punonjësi i autoritetit menaxhues, i pajisur me autorizim nga ministri.

Neni 36
Shqyrtimi

1. Kundërvajtja administrative shqyrtohet nga komisioni i shqyrtimit të kundërvajtjeve administrative, që funksionon pranë drejtorive rajonale të shërbimit pyjor.

2. Vendimi për kundërvajtjet administrative merret nga komisionet përkatëse, që mbulojnë territorin ku ndodh kundërvajtja, brenda 15 ditëve nga data e dorëzimit të procesverbalit.

Neni 37
Ankimi

1. Personi, ndaj të cilit është vendosur gjoba, brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit ose e vënies në dijeni, mund të ankohet te ministri, i cili i përgjigjet brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

2. Kundër vendimit të titullarit, kundërvajtësi mund të ankohet në gjykatë brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së tij.

3. Gjoba paguhet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të formës së prerë. Pas kalimit të këtij afati, personi paguan një kamatë në masën 0,1 për qind të vlerës së gjobës për çdo ditë.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 38
Aktet nënligjore

Ngarkohet ministri që, në zbatim të neneve 3 pika 1, 7 pika 1, 8 pika 3, 11 pika 4, 23 pika 2, 24 pika 2, 25 pika 3 dhe 34 pika 3, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 39
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5620, datë 14.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Bamir Topi

LIGJ
Nr.9868, datë 4.2.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8906, DATË 6.6.2002 "PËR ZONAT E MBROJTURA"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 19 shtohen pikat si më poshtë:

"20. "Ruajtja" nënkupton ndërmarrjen e një sërë masash, për të mbajtur ose rivendosur në një status të favorshëm habitatet natyrore dhe popullatat e llojeve të florës dhe faunës së egër.

21. "Habitatet natyrore" janë sipërfaqet tokësore ose detare, të dallueshme për nga tiparet gjeografike, abiotike dhe biotike, natyrore ose gjysmënatyrore.

22. "Tipa habitati natyror, me interes për komunitetin europian" janë ata tipa, që gjenden në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe plotësojnë njërën nga kushtet e mëposhtme:

i) janë në rrezik zhdukjeje në shtrirjen e tyre natyrore;

ii) kanë një shtrirje të vogël natyrore, si pasojë e regresit të tyre ose të sipërfaqes së tyre të kufizuar;

iii) përfaqësojnë shembuj të jashtëzakonshëm të karakteristikave tipike të rajoneve biogjeografike, alpine dhe mesdhetare.

23. "Tipat përparësorë të habitateve natyrore" janë habitate natyrore, me interes për komunitetin europian, në rrezik zhdukjeje, të cilat ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, për ruajtjen e të cilave Republika e Shqipërisë ka përgjegjësi të veçantë.

24. "Habitat i një lloji" është një mjedis, që përcaktohet nga faktorë specifikë, biotikë dhe abiotikë, ku lloji jeton në çdo fazë të ciklit biologjik të tij.

25 "Lloje me interes për komunitetin europian" janë lloje që, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, plotësojnë njërën nga kushtet e mëposhtme:

i) janë të rrezikuara, me përjashtim të atyre llojeve, shtrirja natyrore e të cilave është e parëndësishme në territor;

ii) janë të prekshme, që do të thotë se ka të ngjarë të bëhen pjesë e kategorive "të rrezikuara" në një të ardhme të afërt, nëse faktorët shkaktarë vazhdojnë të veprojnë;

iii) janë të rralla, që do të thotë se janë lloje me numër të kufizuar, të cilat, edhe pse për çastin nuk janë të rrezikuara apo të prekshme, ndodhen në situatë kritike;

iv) janë endemike dhe kërkojnë vëmendje të posaçme për shkak të natyrës së veçantë të habitatit të tyre dhe/ose ndikimit të mundshëm të shfrytëzimit në habitatin përkatës dhe/ose ndikimit të mundshëm të shfrytëzimit të tyre mbi statusin e ruajtjes.

26. "Lloje përparësore" janë llojet me interes për komunitetin europian, të rrezikuara, për ruajtjen e të cilave Republika e Shqipërisë, për sa i përket shtrirjes së tyre natyrore, ka përgjegjësi të veçantë.

27. "Zonë" është sipërfaqja e përcaktuar gjeografikisht, shtrirja e së cilës përshkruhet me hollësi.

28. "Zonë me interes për komunitetin europian" është zona, rajoni apo rajonet biogjeografike, të cilave ajo u përket, që ndikojnë dukshëm në mirëmbajtjen apo rivendosjen e tipit të habitatit natyror, me interes për komunitetin europian, ose të llojeve, me interes për komunitetin europian, në një status ruajtjeje të favorshëm, ose që ndikon dukshëm në ruajtjen e diversitetit biologjik, brenda rajonit apo rajoneve

biogjeografike në fjalë.

Për llojet shtazore, që gjenden në sipërfaqe të gjera, zonat me interes për komunitetin europian përputhen me vendet brenda shtrirjes natyrore të këtyre llojeve, duke përfaqësuar faktorë fizikë ose biologjikë, thelbësorë për jetën dhe riprodhimin e tyre.

29. "Zona të veçanta ruajtjeje" janë zona me rëndësi për komunitetin europian, të përcaktuara të tilla nga Republika e Shqipërisë me një akt normativ, administrativ ose kontraktual, ku përcaktohen masat e nevojshme ruajtëse për mbajtjen ose rivendosjen në një status të favorshëm ruajtjeje të habitateve natyrore ose të popullatave të llojeve, për të cilat është përcaktuar zona.".

Neni 2

Në nenin 4 pika 3 shfuqizohet.

Neni 3

Pas nenit 4 shtohen nenet 4/1, 4/2, 4/3 e 4/4 me këtë përmbajtje:

"Neni 4/1
Kriteret

Për shpalljen zonë e mbrojtur, territori duhet të plotësojë, të paktën, njërën prej kritereve të mëposhtme:

a) të ketë diversitet të lartë të llojeve dhe/ose të habitateve;
b) të ketë dendësi të ulët të llojeve dhe/ose habitateve;
c) të ketë përfaqësueshmëri;
ç) të ketë minimumin kritik të madhësisë së ekosistemit;
d) të ketë natyralitet, trashëgimi dhe integritet;
dh) të ketë vlera shkencore;
e) të karakterizohet nga prekshmëria ekologjike/llojet e prekshme;
ë) të karakterizohet nga papërsëritshmëria/llojet endemike;
f) të mos rrezikohet nga ndërhyrjet e veprimtarive njerëzore;
g) të ketë mundësi për ruajtjen e jetës së egër.

Neni 4/2
Zonimi i territorit të zonës së mbrojtur

1. Territori i zonës së mbrojtur ndahet në nënzona, sipas rëndësisë së habitateve dhe të ekosistemeve që bëjnë pjesë në to.

2. Zonimi i brendshëm mund të përmbajë zonën qendrore, zonën e rekreacionit, zonën e përdorimit tradicional, zonën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe nënzona të tjera që i përshtaten territorit. Ministri përgjegjës për mjedisin përcakton, me udhëzim, kërkesat dhe mënyrën e zonimit të territorit të një zone të mbrojtur.

3. Zonimi përputh shkallën e mbrojtjes me veçoritë e nënzonës, duke mbajtur parasysh natyrën e zonës, llojet e veprimtarive njerëzore që zhvillohen në të dhe ndikimin e tyre në natyrë.

4. Vendimi i Këshillit te Ministrave, që shpall zonën e mbrojtur, përcakton emërtimin, sipërfaqen dhe shkallën e mbrojtjes së nënzonave të saj.

Neni 4/3
Përcaktimi i zonave të veçanta të ruajtjes

1. Zonat ku strehohen tipat e habitateve natyrore, me interes për komunitetin europian dhe të habitateve te llojeve, me interes për këtë komunitet, shpallen zona të veçanta ruajtjeje. Këto zona janë pjesë e rrjetit ekologjik kombëtar dhe mund të përfshijnë edhe zona të mbrojtura brenda rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, si dhe ekosisteme, habitate e peizazhe jashtë këtij rrjeti.

2. Vlerësimi i rëndësisë së zonave për çdo habitat natyror, përfshirë tipat e habitateve natyrore përparësore dhe llojet përparësore, kryhet sipas këtyre kritereve:

A. Kriteret e vlerësimit të zonës për një tip të caktuar habitati natyror, me interes për komunitetin europian:

a) shkalla e përfaqësueshmërisë së tipit të habitatit natyror në zonën përkatëse;

b) sipërfaqja e zonës së mbuluar nga tipi i habitatit natyror në raport me sipërfaqen e përgjithshme, të mbuluar nga ai tip habitati natyror, brenda territorit kombëtar;

c) shkalla e ruajtjes së strukturës dhe funksioneve të tipit të habitatit natyror në fjalë dhe mundësitë e ripërtëritjes;

ç) vlerësimi global i vlerës së zonës për ruajtjen e tipit përkatës të habitatit natyror.

B. Kriteret e vlerësimit të zonës për një lloj, me interes për komunitetin europian:

a) madhësia dhe dendësia e popullatës së llojit të pranishëm në zonë në raport me popullatat e pranishme brenda territorit kombëtar;

b) shkalla e ruajtjes së tipareve të habitatit, të cilat janë të rëndësishme për llojin në fjalë dhe mundësitë e ripërtëritjes;

c) shkalla e izolimit të popullatës së pranishme në zonë në raport me shtrirjen natyrore të llojit;

ç) vlerësimi global i vlerës së vendit për ruajtjen e llojit përkatës.

3. Në bazë të kritereve, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni dhe të të dhënave përkatëse shkencore, ministri përgjegjës për mjedisin miraton listën e zonave shqiptare, duke përcaktuar tipat e habitateve natyrore, me interes për komunitetin europian dhe llojet, me interes për këtë komunitet, autoktone për territorin shqiptar e që ndodhen në zonë. Në listë identifikohen ato zona, ku gjenden një ose ose disa tipa habitatesh natyrore përparësore ose lloje përparësore.

4. Për llojet e kafshëve, që gjenden në sipërfaqe të gjera, zonat përputhen me vendet brenda shpërndarjes natyrore të këtyre llojeve dhe përfaqësojnë faktorët fizikë dhe biologjikë, thelbësorë për jetën dhe riprodhimin e tyre.

Për llojet ujore, që gjenden në sipërfaqe të gjëra, zonat propozohen vetëm në rastet kur janë qartësisht të identifikueshme dhe përfaqësojnë faktorët fizikë dhe biologjikë, të domosdoshëm për jetën dhe riprodhimin e tyre.

5. Lista dhe të dhënat përkatëse për çdo zonë i dërgohen Komisionit Europian. Të dhënat përfshijnë hartën e zonës, emrin, vendndodhjen, shtrirjen dhe të dhëna të tjera, si rezultat i zbatimit të kritereve të përmendura në pikën 2 të këtij neni. Të dhënat paraqiten në formatin e miratuar prej komisionit.

6. Rregullat për shpalljen e zonave të veçanta të ruajtjes miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4/4

Menaxhimi i zonave të veçanta të ruajtjes

1. Për zonat e veçanta të ruajtjes, ministria përgjegjëse për mjedisin merr masa mbrojtëse, ku përfshihen planet menaxhuese, të hartuara për zonat ose të integruara në plane të tjera zhvillimi, si dhe masa juridike, administrative ose kontraktuale, në përputhje me kërkesat ekologjike të tipave të habitateve natyrore, me interes për komunitetin europian dhe të llojeve me interes për këtë komunitet.

2. Për të shmangur shkatërrimin e habitateve natyrore dhe të habitateve të llojeve në zonat e veçanta të ruajtjes, si dhe shqetësimin e llojeve, për të cilat këto zona janë përcaktuar, ministria përgjegjëse për mjedisin u kërkon personave fizikë e juridikë, veprimtaria e të cilëve ndikon negativisht në zonë, të zbatojnë kërkesat e përcaktuara në lejen mjedisore.

3. Çdo plan ose projekt, që mund të ndikojë në zonë, i nënshtrohet procedurave ligjore të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ministria përgjegjëse për mjedisin pranon planin ose projektin, vetëm pasi sigurohet se ai nuk ndikon negativisht ne integritetin e zonës, si dhe pasi ka marrë mendimin e publikut.

4. Për planin ose projektin, që do të zbatohet për nevoja të ngutshme me interes publik parësor, ministria përgjegjëse për mjedisin i kërkon zbatuesit marrjen e masave kompensuese, që sigurojnë respektimin e ruajtjes së përgjithshme dhe vë në dijeni për to edhe Komisionin Europian.

5. Kur është e nevojshme, në kuadër të planifikimit të përdorimit të tokës, ministria përgjegjëse për mjedisin u kërkon hartuesve dhe zbatuesve të planifikimit të tokës menaxhimin e veçorive të peizazhit, me rendësi të veçantë për florën dhe faunën e egër.

6. Ministria përgjegjëse për mjedisin mbikëqyr statusin e ruajtjes së habitateve natyrore dhe të llojeve, duke u kushtuar kujdes të veçantë habitateve natyrore përparësore dhe llojeve përparësore, si dhe nxit kërkimet dhe punën shkencore, duke pasur parasysh kërkesat e këtij neni.”.

Neni 4

Në titullin e nenit 9, fjalët "(Zonë e menaxhimit të habitateve dhe llojeve)" zëvendësohen me fjalët "(Park natyror)".

Neni 5

Pas nenit 11 shtohet neni 11/1 me këtë përmbajtje:

"Neni 11/1
Parqet natyrore rajonale

1. Përveç zonave të mbrojtura, me karakter kombëtar, që përfshihen në rrjetin përfaqësues të zonave të mbrojtura, këshillat e qarqeve, për nevoja të komunitetit, mund të shpallin parqe natyrore rajonale mjedise, që janë pronë e tyre e që kanë vlera natyrore, të tilla si pyje, kullota, rezervuarë, ligatina etj.

2. Parqet natyrore rajonale sigurojnë një përdorim të qëndrueshëm të territorit dhe zhvillimin e veprimtarive, që i përshtaten karakterit të zonës.

3. Procedurat e propozimit e të miratimit dhe rregullat e administrimit të parqeve natyrore rajonale miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.".

Neni 6

Në nenin 13 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Shpallja e një zone të mbrojtur dhe zonimi i saj bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin, pas marrjes së mendimit të institucioneve të specializuara dhe të organeve të qeverisjes vendore, të cilat kanë marrë, paraprakisht, mendimin e pronarëve privatë, pronat e të cilëve do të përfshihen në zonën e mbrojtur.".

Neni 7

Në nenin 14 pika 1 shkronja "a" ndryshohet si më poshtë:

"a) argumentimi për krijimin e zonës së mbrojtur mbështet objektivat e planit të administrimit të rrjetit përfaqësues të këtyre zonave, epërsitë dhe mangësitë e krijimit të zonës, zonimin e saj, si dhe shkallët e mbrojtjes, të propozuara për secilën zonë.".

Neni 8

Në nenin 23 pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Autoriteti shtetëror, që ngarkohet për administrimin e një zone të mbrojtur dhe administrata e zonës së mbrojtur caktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave për shpalljen e zonës së mbrojtur.".

Neni 9

Në nenin 23 pika 4 shfuqizohet.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5623, datë 18.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9869, datë 4.2.2008

PËR HUAMARRJEN E QEVERISJES VENDORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji janë rregullat, sipas të cilave njësitë e qeverisjes vendore mund të marrin hua dhe çështjet e lidhura me të.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Ky ligj synon zgjerimin e autonomisë vendore, nëpërmjet rregullimit të huamarrjes nga njësitë e qeverisjes vendore dhe krijimit të hapësirës e rregullave të përshtatshme, që sigurojnë një proces transparent huamarrjeje, në përputhje me politikat e zhvillimit në tërësi dhe që garanton stabilitetin makroekonomik dhe kredibilitetin e institucioneve publike në tregjet financiare.

Neni 3
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë ligj, me përjashtim të rasteve kur në këtë nen janë përkufizuar ndryshe, kanë të njëjtin kuptim me atë të të njëjtëve terma të përcaktuar në Kodin Civil dhe në ligjet që rregullojnë:

a) organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore;

b) financat publike, hartimin dhe zbatimin e buxhetit, taksat dhe tarifat vendore, kontabilitetin, huamarrjen shtetërore;

c) pronësinë shtetërore;

ç) veprimtaritë bankare e financiare, titujt, barrët siguruese.

2. "Hua" është një detyrim monetar apo çdo detyrim tjetër, që buron nga një marrëveshje financimi, emetim titujsh apo garanci për të tretë.

3. "Borxh" është shuma e huave të marra në tregun bankar, financiar dhe nga palë të treta, persona fizikë, juridikë ose individë, me kusht kthimi, me ose pa interes, për financimin e projekteve të caktuara apo për arsye të mungesës së përkohshme të likuiditeteve dhe të deficitit fiskal buxhetor.

4. "Shërbimi i borxhit" është pagesa, që duhet kryer në çdo vit fiskal për principalin, interesat, zbritjet dhe pagesat e tjera, që rjedhin nga huatë, përfshirë edhe shpenzimet e lidhura me të.

5. "Marrëveshje financimi" është një marrëveshje me shkrim, që parashikon kushtet dhe rregullat, sipas të cilave huamarrësi merr fonde nga një huadhënës dhe përmban parashikime për shlyerjen e tyre, përfshirë çdo marrëveshje kredie, qira financiare, linjë kredie, overdrafti, marrëveshje shitblerjeje me këste apo marrëveshje tjetër shitblerjeje, si dhe çdo dokument tjetër, sipas të cilit njësia e qeverisjes vendore merr përsipër të shlyejë kostot kapitale të pronave, impianteve dhe pajisjeve në një kohë të dhënë.

6. "Hua afatshkurtër" është huaja, që duhet të shlyhet për një periudhë kohe më të shkurtër se një vit.

7. "Hua afatgjatë" është huaja, që duhet të shlyhet për një periudhë kohe të barabartë ose më të gjatë se një vit.

8. "Titull i njësisë së qeverisjes vendore" është çdo dëftesë huaje, obligacion, apo çdo provë tjetër huamarrjeje, e emetuar nga njësia e qeverisjes vendore, në formë fizike apo jofizike.

9. "Garanci për të tretë" është një detyrim, kontingjent i njësisë së qeverisjes vendore, për t'u bërë përgjegjës, plotësisht apo pjesërisht, për detyrimet financiare të një personi tjetër juridik, në rast se pala, që ka përgjegjësinë parësore për shlyerjen e këtyre detyrimeve financiare, nuk arrin t'i paguajë ato në kohën dhe masën e duhur.

10. "Rast mospërmbushjeje" është mosshlyerja nga njësia e qeverisjes vendore e principalit apo interesit mbi një hua në afatet e caktuara, apo çdo ngjarje tjetër e parashikuar si e tillë në kushtet dhe rregullat e marrëveshjes së huasë.

11. "Regjistri i borxhit vendor" është regjistri i përgatitur nga Ministria e Financave, i cili përmban të dhëna për borxhet e njësive të qeverisjes vendore.

12. "Huadhënës" është çdo person fizik, juridik apo individ që financon, nëpërmjet huasë, njësinë e qeverisjes vendore, përfshirë zotëruesit e titujve të njësisë së qeverisjes vendore, si dhe çdo përfaqësues të autorizuar të këtyre zotëruesve.

13. "Koha e dobishme" është periudha e parashikuar në vite për përdorimin faktik të një investimi kapital, përfshirë mirëmbajtjen e zakonshme.

14. "Borxhi publik" është borxhi që përbëhet nga borxhi shtetëror dhe borxhi vendor.

KREU II
KOMPETENCAT PËR HUAMARRJEN VENDORE

Neni 4
Qëllimi i huasë

1. Njësia e qeverisjes vendore mund të marrë hua afatshkurtër, për të financuar mungesën e përkohshme të likuiditeteve.

2. Njësia e qeverisjes vendore mund të marrë hua afatgjatë për të:

a) financuar shpenzime kapitale, që shërbejnë për një funksion të njësisë së qeverisjes vendore;

b) rifinancuar hua afatgjatë ekzistuese, të marrë sipas shkronjës "a" të kësaj pike. Huaja e marrë sipas kësaj pike duhet të jetë me afat maturimi më të gjatë se huaja që rifinancon.

3. Njësia e qeverisjes vendore mund të lëshojë garanci në favor të subjekteve të kontrolluara prej saj për hua, që merren prej këtyre subjekteve, për financimin e shpenzimeve kapitale, që shërbejnë për një funksion të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 5
Kushtet e huasë

1. Huaja mund të ketë interes me normë fikse ose të ndryshueshme.

2. Huaja mund të merret në monedhë vendase ose në monedhë të huaj. Huaja afatshkurtër merret vetëm në monedhë vendase.

3. Huaja afatshkurtër maturohet dhe është e pagueshme deri në ditën e fundit të muajit nëntor të vitit fiskal, në të cilin merret dhe nuk mund të jetë objekt i rifinancimit apo i zgjatjes së afatit të maturimit përtej kësaj date.

4. Huaja afatgjatë nuk mund të ketë maturim dhe nuk mund të bëhet e pagueshme përtej kohës së dobishme të investimit kapital, të financuar me të hyrat e kësaj huaje.

5. Huaja mund të jetë subjekt i kushteve të parapagimit, në përputhje me kushtet e rregullat e parashikuara në marrëveshjen e saj.

Neni 6
Kompetenca për huamarrjen afatshkurtër

1. Njësia e qeverisjes vendore merr hua afatshkurtër, në përputhje me vendimin në parim të këshillit të saj, për buxhetin e kësaj njësie për vitin aktual fiskal. Brenda kufizimit të lejuar nga ky ligj, për borxhin afatshkurtër këshilli përcakton kufirin konkret, brenda të cilit, gjatë zbatimit të buxhetit, kryetari i njësisë së qeverisjes vendore është i autorizuar të marrë hua afatshkurtër, rast për rast.

2. Huaja afatshkurtër përdoret nga njësia e qeverisjes vendore vetëm pas një përgjigjeje negative nga Ministria e Financave për mbulimin e nevojave për likuiditete me hua, pa ose me interes, nga Buxheti i Shtetit. Ministria e Financave përgjigjet brenda dhjetë ditëve nga data e marrjes së kërkesës për likuiditete. Vlerësohet se Ministria e Financave ka dhënë përgjigje negative, kur nuk shprehet brenda këtij afati dhe njësia e qeverisjes vendore mund të kërkojë hua afatshkurtër nga burime të tjera.

3. Njësia e qeverisjes vendore, brenda dhjetë ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes së huasë afatshkurtër, njofton Ministrinë e Financave për marrjen e kësaj huaje dhe kushtet e saj, si dhe bën përshkrimin e respektimit të kufizimeve për borxhin afatshkurtër, sipas kreut IV të këtij ligji.

4. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në mbledhjen më të afërt të këshillit të kësaj njësie, njofton për marrjen e borxhit afatshkurtër, kushtet dhe rregullat e tij, përfshirë marrëveshjen me

huadhënësin, për kriteret dhe procesin e përzgjedhjes së huadhënësit, si dhe bën përshkrimin e respektimit të kufizimeve për borxhin afatshkurtër, të vendosur nga këshilli, sipas pikës 1 të këtij neni.

Neni 7
Kompetenca për huamarrjen afatgjatë

1. Njësia e qeverisjes vendore merr hua me vendim të këshillit për huamarrjen, të miratuar me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit, në një mbledhje të hapur për publikun.

2. Vendimi i këshillit autorizon kushtet e huamarrjes dhe përmban të dhënat e mëposhtme:

a) shumën e principalit të huasë;

b) normën e interesit;

c) formën e huasë;

ç) maturimin dhe kushtet e kthimit;

d) qëllimin për të cilin merret huaja;

dh) garancitë për kthimin e huasë, përfshirë edhe përshkrimin e të ardhurave të vëna peng, nëse ka;

e) përshkrimin e respektimit të kufizimeve të borxhit, sipas kreut IV të këtij ligji;

ë) kohën e dobishme të aseteve, të financuara nga huaja.

3. Njoftimi për mbledhjen e këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, në të cilën do të shqyrtohet vendimi, duhet të botohet në një gazetë me tirazh të konsiderueshëm, jo më pak se pesëmbëdhjetë ditë para datës së mbledhjes. Ky njoftim duhet të përmbajë edhe të dhënat, sipas pikës 2 të këtij neni.

4. Njësia e qeverisjes vendore, brenda dhjetë ditëve nga miratimi i vendimit, duhet të njoftojë Ministrinë e Financave për marrjen e kësaj huaje. Njoftimi duhet të përmbajë:

a) vendimin që autorizon huanë;

b) të ardhurat dhe shpenzimet operative të vitit të mëparshëm fiskal;

c) koston e shërbimit të borxhit për vitin fiskal aktual, përfshirë edhe koston e parashikuar të huasë së re.

Pavarësisht sa është thënë më lart, brenda datës 31 dhjetor të çdo viti, çdo njësi e qeverisjes vendore duhet të njoftojë Ministrinë e Financave për planet e huamarrjes për vitin e ardhshëm fiskal.

5. Vendimi për huanë afatgjatë hyn në fuqi pas konfirmimit nga Ministri i Financave. Ministri i Financave kufizohet vetëm në konfirmimin e përputhshmërisë procedurale për autorizimin e huasë, në përputhje me këtë nen dhe verifikimin e respektimit të kufizimeve të borxhit, të parashikuara në kreun IV të këtij ligji. Vlerësohet se Ministri i Financave e ka konfirmuar huanë, në rast se nuk përgjigjet brenda njëzet ditëve nga data e marrjes së njoftimit, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Pavarësisht pikës 5 të këtij neni, huaja:

a) e marrë për rifinancimin e një huaje tjetër;

b) e marrë në tregjet ndërkombëtare;

c) e marrë nga një njësi e qeverisjes vendore, e cila ka pasur një rast të vështirësisë financiare, gjatë pesë viteve paraardhëse, është subjekt i miratimit të Ministrit të Financave.

7. Miratimi nga Ministri i Financave, sipas pikave 5 e 6 të këtij neni, nuk përbën garanci dhe nuk krijon asnjë lloj detyrimi të Republikës së Shqipërisë për kthimin e huasë.

Neni 8
Titujt e njësisë së qeverisjes vendore

1. Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, në përputhje me vendimin e këshillit për huamarrjen, emeton titujt e njësisë së qeverisjes vendore, në formën e regjistrimit në llogari apo në formë fizike. Kryetari autorizon krijimin e sistemit të regjistrimit kompjuterik për titujt e emetuar në formën e regjistrimit në llogari, si dhe administrimin e këtij sistemi, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një ndërmjetësi.

2. Titujt e emetuar në formën e regjistrimit në llogari janë detyrime të njësisë së qeverisjes vendore dhe nuk ndryshojnë nga titujt e emetuar në formë fizike, megjithëse emetimi, mbajtja e llogarisë dhe transaksionet e tyre, përfshirë edhe pagesa në maturim, realizohen në mënyrë elektronike, duke përdorur të dhëna të ndërlidhura kompjuterike, të mbajtura nga/dhe nëpërmjet ndërmjetësve, të cilët veprojnë në cilësinë e agjentit apo të kujdestarit.

3. Titujt e emetuar në formë të certifikuar apo fizike janë detyrime të njësisë së qeverisjes vendore, të cilat identifikohen nëpërmjet serive të emetimit, numrit përkatës serial dhe vlerës nominale dhe mund të jenë në formë të regjistruar ose të pagueshme për zotëruesin. Titujt e njësisë së qeverisjes vendore mund të emetohen në formë fizike, për të evidentuar në mënyrë kolektive një numër titujsh, që mbajnë të njëjtin përshkrim, por që emetohen në formën e regjistrimit në llogari.

4. Titujt e njësisë së qeverisjes vendore mund të jenë të tregtueshëm ose të patregtueshëm, në varësi të kushteve të emetimit.

5. Emetimi i titujve të njësisë së qeverisjes vendore bëhet në përputhje me ligjin në fuqi, që rregullon emetimin, transaksionet me titujt, si dhe subjektet e përfshira në këto transaksione.

Neni 9

Natyra e detyrimit për të shlyer huanë

1. Kthimi i huasë së njësisë së qeverisjes vendore, në përputhje me kushtet dhe afatet e përcaktuara, është përgjegjësi vetëm e kësaj njësie, përveçse kur garantohet shprehimisht nga një person tjetër. Huamarrja nga njësitë e qeverisjes vendore nuk përbën asnjë detyrim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë të Republikës se Shqipërisë, përveçse kur Ministri i Financave ka nënshkruar marrëveshje të garancisë shtetërore për huanë.

2. Buxheti i njësisë së qeverisjes vendore përfshin shumën e shërbimit të borxhit, që duhet të paguhet në atë vit.

3. Marrëveshja e financimit apo titujt e njësisë së qeverisjes vendore përcaktojnë burimet e të ardhurave, që janë vendosur si garanci për shlyerjen e huasë, nëse ka, në përputhje me kreun III të këtij ligji.

4. Përveç rasteve kur Ministria e Financave ka lëshuar një garanci shtetërore për huanë, marrëveshja e financimit apo titulli përmban dispozitën se huaja është e pagueshme vetëm nga burimet e parashikuara në dispozitat e saj dhe nuk përbën detyrim të Republikës së Shqipërisë. Çdo instrument huaje, që nuk përmban këtë përcaktim, është i pavlefshëm.

5. Çdo hua e vlefshme e njësisë së qeverisjes vendore përbën përgjegjësi të vlefshme, detyruese dhe të ekzekutueshme për këtë njësi, me fuqi detyruese për organet ekzistuese dhe ato të ardhshme të kësaj njësie.

Neni 10

Të hyrat e huasë

1. Të hyrat e huasë përdoren vetëm për qëllimin e autorizuar në vendimin e këshillit të njësisë së qeverisjes vendore. Në rast se këshilli, pas marrjes së huasë, vendos ta ndryshojë qëllimin e marrjes së saj, duhet të ndryshojë edhe vendimin, për të pasqyruar ndryshimin e qëllimit, sipas të njëjtave procedura, të kërkuara për vendimin fillestar, si dhe të marrë pëlqimin e huadhënësit për këtë ndryshim. Në rast se huaja është emetuar në formë titulli, merret pëlqimi i asaj përqindjeje të pronarëve të titujve, që është përcaktuar në kushtet fillestare të emetimit të huasë.

2. Vendimi, që autorizon huanë, mund të parashikojë krijimin e një fondi rezervë veçmas dhe të ndarë nga fondet e tjera të njësisë së qeverisjes vendore dhe të përdoret vetëm për qëllimet e shërbimit të borxhit, në rast se njësia e qeverisjes vendore nuk është e aftë të kryejë këto pagesa, sipas kushteve e rregullave të huasë.

Neni 11

Investimi i fondeve të huasë

Të hyrat e huasë, fondet e mbajtura rezervë për të kryer pagesat e borxhit, përfshirë çdo fond rezervë, sipas nenit 10 pika 2 të këtij ligji, si dhe çdo e ardhur e vënë garanci për shlyerjen e huasë mund:

a) të mbahen në llogari të veçanta;

b) të investohen vetëm në titujt e shtetit ose depozita me afat, në banka të miratuara nga Ministria e Financave, vetëm kur këto maturohen përpara datës së pritshme të kryerjes së shpenzimit të këtyre fondeve, për qëllimin e autorizuar.

Çdo e ardhur nga investimi i këtyre fondeve përdoret, në radhë të parë, për të mbuluar shpenzimet që financohen nga huaja dhe për pagesën e shërbimit të borxhit.

KREU III

Neni 12

Huaja me detyrim të përgjithshëm

1. Huaja afatshkurtër dhe afatgjatë e njësisë së qeverisjes vendore përbën detyrim të përgjithshëm të kësaj njësie, i pagueshëm si shpenzim parësor nga të gjitha fondet, ligjërisht të disponueshme, të njësisë së qeverisjes vendore, të cilat nuk janë vendosur si garanci për huadhënës të tjerë, sipas nenit 13 të këtij ligji.

2. Të gjitha huatë me detyrim të përgjithshëm gëzojnë paritet dhe barazi statusi, pavarësisht nga koha kur janë krijuar dhe pavarësisht nëse janë në formë titujsh apo marrëveshjesh financimi.

Neni 13
Garanci të tjera të ardhurash

1. Huaja me detyrim të përgjithshëm mund të garantohet nga të gjitha apo nga një pjesë e atyre të ardhurave, për të cilat njësia e qeverisjes vendore ka autoritet të plotë shpenzimi.

2. Çdo vënie garancie e të ardhurave duhet të përshkruhet në vendimin e këshillit, që autorizon huanë.

3. Të ardhurat e vëna garanci mund të identifikohen veçmas në sistemin e thesarit, të ndara nga fondet e tjera të njësisë së qeverisjes vendore.

4. Të ardhurat e vëna garanci përdoren në përputhje me kushtet e huasë dhe huadhënësi gëzon përparësi mbi këto të ardhura, kundrejt çdo pale të tretë.

5. Garancitë e dhëna nga njësia e qeverisjes vendore nuk e detyrojnë, në asnjë rast, pushtetin qendror për të bërë pagesa të tilla për llogari të kësaj njësie.

Neni 14
Interceptimi i financimit

Njësia e qeverisjes vendore mund të japë garanci shtesë për huanë e garantuar, sipas nenit 13 të këtij ligji, duke lidhur një marrëveshje që, në rast mospërmbushjeje, lejon pagesën e huasë drejtpërdrejt nga transfertat e pakushtëzuara ose taksat e ndara të pagueshme nga Buxheti i Shtetit për llogari të kësaj njësie. Këto fonde i paguhen huadhënësit, në përputhje me kushtet dhe rregullat e marrëveshjes së huasë.

Neni 15
Garanci me prona fizike

Huaja me detyrim të përgjithshëm mund të garantohet edhe me pronë jopublike, fizike, të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 16
Lloje të tjera garancie

Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore mund të ofrojë garanci të tjera, duke u angazhuar:

a) të zbatojë taksa e tarifa në një nivel të caktuar, të lejuar nga ligji, për të vjelë një shumë të caktuar të ardhurash;

b) të administrojë një ndërmarrje apo pronë tjetër, në përputhje me kushtet e huasë;

c) të kryejë pagesat drejtpërdrejt nga fonde apo burime, që bëhen të disponueshme dhe të autorizojë akses të drejtpërdrejtë në këto burime, për të garantuar pagesën e huasë;

ç) të depozitojë fonde apo të ardhura të vëna garanci pranë apo për llogari të huadhënësit;

d) të pranojë procedura specifike pagimi, për të siguruar pagesën ekskluzive apo të dedikuar për huadhënësin, përfshirë interceptimin e të ardhurave, pagesat në llogari të veçanta, apo mekanizma ose procedura të tjera pagese;

dh) të pranojë kufizime për hua të mëtejshme;

e) të zgjidhë mosmarrëveshjet me anë të ndërmjetësimit, arbitrazhit apo mekanizmave të tjerë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;

ë) të pranojë marrëveshje të tjera, që i vlerëson të nevojshme dhe të dobishme për marrjen e huasë

dhe ofrimin e garancisë për shlyerjen e saj.

KREU IV
KUFIZIMET E BORXHIT

Neni 17
Kufizimet e borxhit afatshkurtër

Shuma e përgjithshme e borxhit afatshkurtër në asnjë rast nuk mund të tejkalojë më shumë se dhjetë për qind të të ardhurave faktike, gjithsej, nga taksat dhe tarifat vendore dhe taksat e tatimet e ndara të vitit fiskal paraardhës.

Neni 18
Kufizimet e borxhit afatgjatë

1. Raporti i tepricës operative të vitit fiskal paraardhës (të llogaritur si diferenca e të ardhurave operative, nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transferta e pakushtëzuar me shpenzimet jo të kushtëzuara operative të njësisë së qeverisjes vendore) me shërbimin e borxhit, që duhet të paguhet çdo vit për borxhin afatgjatë, është jo më pak se 1,4 : 1.

2. Raporti i stokut të borxhit ndaj të ardhurave operative, gjithsej, nga burimet e veta, taksat e ndara dhe transferta e pakushtëzuar, është jo më shumë se 1,3 : 1.

3. Shërbimi i borxhit, që duhet të paguhet çdo vit për borxhin afatgjatë, nuk mund të tejkalojë njëzet për qind të buxhetit total të të ardhurave nga transferta e pakushtëzuar, taksat dhe tatimet e ndara dhe taksat e tarifat vendore të tri viteve fiskale paraardhëse të njësisë së qeverisjes vendore:

a) përllogaritja e interesave, për efekt të respektimit të kufizimeve të borxhit, bazohet në normën zyrtare të interesit të ditës kur bëhet përllogaritja;

b) përllogaritja e principalit dhe e interesave të pagueshëm për huanë në monedhë të huaj bëhet në bazë të kursit zyrtar të këmbimit, të shpallur nga Banka e Shqipërisë, në ditën kur bëhet përllogaritja;

c) në rastin kur njësia e qeverisjes vendore garanton hua të marrë nga të tretë, përllogaritja, për qëllim të kufizimit të borxhit, e konsideron huanë sikur të jetë marrë nga ajo vetë në përpjesëtim me kushtet e garancisë;

ç) respektimi i parashikimeve për kufizimet e borxhit përcaktohet nga njësia e qeverisjes vendore, sipas një njoftimi, që depozitohet në Ministrinë e Financave, në kohën e marrjes së huasë dhe ndryshimet e mëvonshme në normën e interesit apo në kursin e këmbimit, për shkak të të cilave shërbimi i borxhit tejkalon kufizimet, nuk përbëjnë shkelje të kufizimeve të borxhit apo nuk cenojnë vlefshmërinë e huasë, që ka qenë në përputhje në kohën e emetimit.

Neni 19
Kufizimet e linjës së kredisë

Linja e kredisë kufizohet për qëllim të borxhit afatshkurtër apo afatgjatë, në bazë të tavanit të linjës së kredisë, pavarësisht nga masa e përdorimit të saj faktik.

Neni 20
Kufizimi shumator i borxhit

1. Shuma e borxhit afatshkurtër dhe afatgjatë, për të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, u nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në ligjin "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" mbi kufijtë e borxhit publik.

2. Kufizimi shumator për borxhin afatshkurtër dhe atë afatgjatë të njësisë së qeverisjes vendore është i barabartë me kufizimin për borxhin afatgjatë, sipas nenit 18 të këtij ligji.

KREU V
SUBJEKTI ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA

Neni 21
Huamarrja nga subjekti me kompetenca të përbashkëta

Njësia e qeverisjes vendore mund t'i delegojë një subjekti me kompetenca të përbashkëta të drejtën për të krijuar borxh. Ky subjekt merr hua dhe krijon borxh në përputhje me këtë ligj dhe marrëveshjen për krijimin e tij. Kufizimi i borxhit për llogari të njësisë së qeverisjes vendore, themeluese e këtij subjekti, është në proporcion me angazhimin e saj në këtë marrëveshje.

KREU VI
MASAT KORRIGJUESE

Neni 22
Masat korrigjuese

1. Në rast vazhdimësie të një rasti mospërmbushjeje për tridhjetë ditë të njëpasnjëshme, njësia e qeverisjes vendore dhe huadhënësi duhet të informojnë Ministrinë e Financave brenda pesë ditëve pune nga ky afat. Ministria e Financave bën një shënim në regjistrin e borxhit vendor, që identifikon detyrimin e huasë si të mospërmbushur.

2. Në rast mospërmbushjeje, huadhënësit e huave të garantuara me të ardhura specifike janë të autorizuar të marrin në zotërim dhe të përdorin, në përputhje me termat dhe kushtet e huasë ose të marrëveshjes së interceptimit, të ardhurat e vëna garanci, derisa i gjithë principali dhe interesat e huasë të jenë paguar plotësisht.

3. Në rast mospërmbushjeje, huadhënësit kanë të drejtë të marrin të gjitha masat e mundshme ligjore kundër njësisë së qeverisjes vendore.

4. Në rast mospërmbushjeje, Ministria e Financave i kërkon njësisë së qeverisjes vendore të hartojë dhe të paraqesë një plan masash për korrigjimin e situatës dhe kthimin në normalitet të pagesave të borxhit.

Neni 23
Vështirësia financiare

1. Njësia e qeverisjes vendore ndodhet në një rast të vështirësisë financiare kur:

a) llogaritë e pashlyera, të cilave u ka kaluar afati me më shumë se nëntëdhjetë ditë, në fund të çdo tremujori të vitit fiskal, tejkalojnë tridhjetë për qind të buxhetit të njësisë së qeverisjes vendore për këtë tremujor;

b) huaja afatshkurtër nuk është shlyer plotësisht deri në ditën e fundit të muajit nëntor të vitit buxhetor, kur është marrë kjo hua.

2. Ministria e Financave, me marrjen e njoftimit nga njësia e qeverisjes vendore ose kur e vëren vetë, e shpall këtë njësi në vështirësi financiare dhe bën një shënim në regjistrin e borxhit vendor për këtë qëllim.

3. Me shpalljen, sipas pikës 2 të këtij neni, njësia e qeverisjes vendore është subjekt i mbikëqyrjes financiare nga Ministria e Financave dhe nuk mund:

a) të marrë asnjë vendim, që mund të çojë në shtimin e detyrimeve të saj financiare;

b) të vendosë shërbime të reja publike, të themelojë sipërmarrje publike apo çdo institucion tjetër;

c) të shlyejë asnjë detyrim financiar, të krijuar para shpalljes së rastit të vështirësisë financiare, përveç detyrimeve, të përcaktuara shprehimisht në planin e rehabilitimit financiar, sipas pikës 4 të këtij neni;

ç) të marrë hua pa miratimin e Ministrisë së Financave.

4. Këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, brenda gjashtëdhjetë ditëve nga marrja e njoftimit për vështirësinë financiare, sipas pikës 2 të këtij neni, miraton një plan rehabilitimi financiar, të cilin ia dorëzon për miratim Ministrisë së Financave. Përgatitja e planit të rehabilitimit bëhet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, me asistencë nga Ministria e Financave.

5. Në rast se njësia e qeverisjes vendore nuk e dorëzon planin e rehabilitimit brenda afatit të përcaktuar në pikën 4 të këtij neni, plani përgatitet nga Ministria e Financave.

6. Zbatimi i planit të rehabilitimit është i detyrueshëm për njësinë e qeverisjes vendore. Njësia e qeverisjes vendore dorëzon pranë Ministrisë së Financave, me kërkesë të kësaj ministrie, por të paktën një herë në muaj, raporte të hollësishme për realizimin e masave, sipas këtij plani.

Neni 24
Dalja nga vështirësia financiare

Ministria e Financave shpall se njësia e qeverisjes vendore pushon së qeni subjekt i masave, sipas nenit 23 të këtij ligji, në rast se kjo njësi:

a) nuk ka deficit buxhetor për dy vite të njëpasnjëshme;

b) bën kërkesë për çlirimin nga këto masa dhe Ministria e Financave vlerëson se njësia ka ndërmarrë masa, me të cilat mund të përmirësohet gjendja financiare e njësisë së qeverisjes vendore dhe të eliminohen kushtet, që kanë shkaktuar rastin e vështirësisë financiare;

c) deklaron dhe argumenton se është në përputhje me planin e rehabilitimit dhe nuk ndodhet më në kushtet e një rasti të vështirësisë financiare.

Neni 25
Paaftësia paguese

1. Rast i paaftësisë paguese shfaqet, kur njësia e qeverisjes vendore:

a) nuk përmbush detyrimin për shlyerjen e principalit ose të interesit të një detyrimi huaje apo garancie për të tretë, të marrë dhe të njohur prej saj, apo është subjekt i një vendimi gjykate të formës së prerë, kur kjo mospërmbushje ka vazhduar për një periudhë prej gjashtëdhjetë ditësh e kur shuma tejkalon tridhjetë për qind të të ardhurave, gjithsej, të njësisë së qeverisjes vendore nga taksat e tarifat vendore, taksat e ndara dhe transferta e pakushtëzuar në vitin buxhetor paraardhës;

b) ka llogari të pashlyera, që tejkalojnë shumën tridhjetë për qind të buxhetit të saj vjetor, për një periudhë prej nëntëdhjetë ditësh të njëpasnjëshme dhe kjo ka pasur një ndikim të dukshëm negativ në shërbimet bazë që ofron njësia.

2. Procesi për administrimin e paaftësisë paguese dhe procedurat përkatëse përcaktohen me ligj të veçantë.

KREU VII
TË NDRYSHME

Neni 26
Regjistri i borxhit vendor

Ministria e Financave mban një regjistër të të gjitha huave të njësive të qeverisjes vendore, i cili përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga kjo ministri dhe botohet një herë në gjashtë muaj.

Neni 27
Aneksi i borxhit në buxhetin vendor

Çdo njësi e qeverisjes vendore mban një regjistër të veçantë për borxhin e saj, ku pasqyrohen të dhënat e përcaktuara në nenin 7 pika 2 të këtij ligji, si dhe çdo të dhënë tjetër, që lidhet me përdorimin dhe shlyerjen e huasë. Detyrimet e njësisë së qeverisjes vendore ndaj huadhënësve pasqyrohen në një aneks të veçantë të buxhetit vjetor të njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 28
Informacioni publik

Të gjitha dokumentet e lidhura me huamarrjen vendore janë dokumente zyrtare dhe janë të lejueshme për publikun, në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare.

Neni 29

Librat dhe llogaritë

Njësia e qeverisjes vendore ka detyrimin të mbajë regjistrat dhe informacionin e nevojshëm, për të lejuar verifikimin e kushteve të huave dhe të respektimit të kushteve të vendimit të këshillit për huamarrjen, përfshirë, por jo kufizuar në përdorimin e të hyrave të huasë, në përputhje me këtë vendim. Ky informacion do të jetë publik, sipas kuptimit të nenit 28 të këtij ligji.

Neni 30
Kompetencat e zyrtarëve të njësisë së qeverisjes vendore

Kryetari dhe çdo zyrtar i njësisë së qeverisjes vendore, i autorizuar sipas vendimit të këshillit për huamarrjen, janë të autorizuar të ndërmarrin çdo veprim të nevojshëm për apo të lidhur me huamarrjen, në përputhje me kushtet dhe rregullat e këtij vendimi.

Neni 31
Trajtimi fiskal

Interesi për borxhin e njësisë së qeverisjes vendore është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në të njëjtën masë e mënyrë, si huaja e borxhit të shtetit.

Neni 32
Detyrimet e huave të marra para këtij ligji

Çdo hua e njësive të qeverisjes vendore, e kontraktuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbetet në fuqi, sipas kushteve e termave të saj, megjithatë zbatohen kufizimet e borxhit, sipas kreut IV të këtij ligji.

Neni 33
Përparësia ligjore

Në rast mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të këtij ligji dhe të ligjeve të tjera në fuqi, që përmbajnë dispozita për ose kanë lidhje me huamarrjen nga njësitë e qeverisjes vendore, ky ligj ka epërsi.

Çdo hua e njësive të qeverisjes vendore, e kontraktuar para hyrjes në fuqi të këtij ligji, mbetet në fuqi.

Neni 34
Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë akte nënligjore për:

a) llojin e të dhënave, formën dhe standardet e mbajtjes së tyre në regjistrin e huasë, të borxhit vendor pranë Ministrisë së Financave, si dhe në regjistrin e borxhit të çdo njësie të qeverisjes vendore dhe raportimin e njësive të qeverisjes vendore pranë kësaj ministrie;

b) rregullat e përdorimit të mekanizmit të interceptimit;

c) investimin e fondeve të lidhura me huatë vendore dhe menaxhimin e llogarive në banka të nivelit të dytë për këtë qëllim;

ç) mënyrën e përllogaritjes së kufizimeve të borxhit vendor.

Neni 35
Dispozita kalimtare

1. Njësitë e qeverisjes vendore mund të fillojnë të marrin hua nga data 1 mars 2008.

2. Ngarkohet Ministri i Financave të nxjerrë të gjitha aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

3. Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme, në bashkëpunim me shoqatat e njësive të qeverisjes vendore, organizojnë informimin dhe trajnimin e këtyre njësive, si dhe të subjekteve që operojnë në tregun bankar e financiar.

Neni 36
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5624, datë 18.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ
Nr.9870, datë 4.2.2008

PËR STANDARDIZIMIN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti dhe qëllimi

1. Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për:
a) zhvillimin e të gjitha veprimtarive të standardizimit në nivel kombëtar;
b) organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, si organi kombëtar i standardizimit në Shqipëri.
2. Qëllimi i këtij ligji është përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues në fushën e standardizimit, përfshirë dhe përgatitjen e publikimin e standardeve shqiptare, si dhe zbatimin e tyre.

Neni 2
Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për standardet e hartuara e të adoptuara në fushën e inxhinierisë, të transportit, bujqësisë dhe ushqimit, madhësitë dhe njësitë.
2. Ky ligj nuk zbatohet për standarde të hartuara, të adoptuara dhe të miratuara në shoqëri, agjenci, organizata apo sektorë të tjerë të ekonomisë, si dhe për standardet e fushës së telekomunikacionit, për të cilat është përgjegjës enti përkatës i telekomunikacionit.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:
1. "Standardizim" është veprimtaria për krijimin, për probleme aktuale apo që mund të lindin, të rregullave/dispozitave, për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, për një nivel optimal rregulli në një kontekst të dhënë. Në veçanti, veprimtaria ka të bëjë me proceset e përgatitjes, të publikimit dhe zbatimit të standardeve. Standardizimi është një veprimtari vullnetare, si rezultat i një konsensusi, i realizuar nga dhe për vetë palët e interesuara, bazuar në gjithëpërfshirje dhe transparencë.
2. "Organizëm kombëtar standardizimi" është organizmi i standardizimit, i njohur në nivel kombëtar, i cili, me ligj, gëzon të drejtën e përfaqësuesit kombëtar të organizatave homologe, ndërkombëtare dhe rajonale, të standardeve.
3. "Organizatë ndërkombëtare e standardizimit" është një organizëm standardizimi, anëtarësimi në të cilin është i hapur për organizmat kombëtarë, përkatës të çdo vendi.
4. "Organizatat europiane të standardizimit" janë Komiteti Europian i Standardizimit (CEN), Komiteti Europian i Standadizimit në Fushën e Elektroteknikës (CENELEC) dhe Instituti Europian i Standardeve të Telekomunikacionit (ETSI).
5. "Standard" është çdo dokument vullnetar, i hartuar me konsensus dhe i miratuar nga një

organizëm i njohur standardizimi, i cili ofron, për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime ose karakteristika për veprimtari apo rezultatet e tyre, për një shkallë optimale rregulli, në një kontekst të dhënë.

6. "Standard ndërkombëtar" është çdo standard, i cili është adoptuar nga një organizatë ndërkombëtare standardizimi dhe që i është vënë në dispozicion publikut.

7. "Standard europian" (EN) është çdo standard vullnetar, i adoptuar nga njëra prej organizatave europiane të standardizimit dhe që i është vënë në dispozicion publikut.

8. "Dokument harmonizimi" (HD) është një dokument normativ vullnetar, i adoptuar nga njëra prej organizatave europiane të standardizimit, me detyrimin e zbatimit të përmbajtjes teknike në Shqipëri dhe shfuqizimin e standardeve kombëtare e të dokumenteve normative shqiptare, që bien ndesh me ato europiane.

9. "Standard i harmonizuar" është çdo standard europian (EN) ose një dokument harmonizimi (HD) i adoptuar nga njëra prej organizatave europiane të standardizimit, në zbatim të një mandati, të lëshuar nga Komisioni Europian, pas këshillimeve me vendet anëtare, numrat e referencës të të cilit publikohen në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Europian.

10. "Standard shqiptar" është çdo dokument i miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit, më poshtë DPS, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe që shënohet me (SSH).

11. "Standard shqiptar i harmonizuar" është çdo standard shqiptar, që ka adoptuar një standard europian të harmonizuar, sipas rregullave teknike.

12. "Dokument standardizimi" është çdo dokument, i miratuar nga organizmat europianë ndërkombëtarë dhe i adoptuar nga organizmat kombëtarë të standardizimit, siç janë specifikimet teknike, raportet teknike, manualet apo marrëveshjet e veçanta teknike, i cili është vënë në dispozicion të publikut.

13. "Programi i punës së standardizimit" është një program pune i një organizmi standardizimi, i cili përmban elementet e veprimtarisë së standardizimit për një periudhë të caktuar kohore.

14. "Referim tregues ndaj standardeve" është një referim ndaj standardeve, i cili përcakton se njëra nga mënyrat, për të përmbushur kërkesat përkatëse të një rregulli teknik, është zbatimi i standardit, referuar në aneksin e rregullit.

Neni 4

Parimet e veprimtarisë kombëtare të standardizimit

Parimet e veprimtarisë kombëtare të standardizimit janë:

a) e drejta e pjesëmarrjes vullnetare të të gjitha palëve të interesuara në hartimin, miratimin dhe adoptimin e standardeve shqiptare, si dhe në zbatimin vullnetar të tyre;

b) konsensusi i të gjitha palëve të interesuara për përmbajtjen e standardeve shqiptare;

c) transparenca në të gjitha fazat e punës së standardizimit, nëpërmjet publikimit e informimit të publikut;

ç) parandalimi, që interesat individualë të mbizotërojnë ata të përgjithshëm;

d) pjesëmarrja në punën europiane e ndërkombëtare të standardizimit, zbatimin e standardeve europiane e ndërkombëtare si standarde shqiptare.

Neni 5

Qëllimi i veprimtarisë së standardizimit

Qëllimi i veprimtarisë së standardizimit është:

a) të rrisë nivelin e sigurisë së produkteve dhe proceseve, në mbrojtje të shëndetit e jetës së personave, si dhe mjedisin, duke ndihmuar në zbatimin e legjislacionit, në funksion të kërkesave për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, sigurisë e shëndetit, mbrojtjes së mjedisit dhe konsumatorit, duke siguruar, në këtë mënyrë, rregulla të përbashkëta;

b) të promovojë cilësinë e produkteve, të proceseve dhe të shërbimeve;

c) të sigurojë përdorimin me efektivitet të punës, të materialeve dhe të energjisë;

ç) të përmirësojë efektshmërinë e produkteve, të kontrolleve të ndryshme, duke siguruar përputhshmërinë dhe ndërveprimin;

d) të ndihmojë në heqjen e barrierave teknike në tregtinë ndërkombëtare.

Neni 6

Identifikimi i standardeve shqiptare

1. Standardet shqiptare identifikohen me emërtim shkronjash dhe numrash. Emërtimi do të përmbajë shkronjat “SSH” apo një ndërthurje të shkronjave “SSH” me shkronja të tjera, sipas origjinës, në rastet e zbatimit të standardeve europiane ose ndërkombëtare. Pjesa numerike përmban numrin e standardit dhe vitin e miratimit të tij.

2. Këto emërtime nuk përdoren nga standarde të tjera, që krijohen nga shoqëri apo entitete të tjera në Republikën e Shqipërisë, përveç DPS-së.

Neni 7

Zbatimi i standardeve shqiptare

1. Zbatimi i standardeve shqiptare është vullnetar.

2. Standardet shqiptare janë të njëjta për të gjithë personat fizikë dhe/ose juridikë, vendas apo të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë.

3. Një rregull teknik, i cili përmban kërkesa thelbësore, mund t’u referohet standardeve shqiptare ose pjesëve të tyre, vetëm atëherë kur ky rregull teknik transpozon direktiva të Bashkimit Europian. Referimi ndaj këtyre standardeve duhet bërë si “Standarde shqiptare të harmonizuara”.

4. Standardet shqiptare të harmonizuara, të miratuara nga DPS-ja, pas këshillimeve dhe me propozimin e ministrive dhe të autoriteteve të tjera ekzekutive, i propozohen Këshillit të Ministrave për miratim me listë me rregullat teknike përkatëse. Lista e standardeve shqiptare të harmonizuara, si dhe çdo rishikim i tyre publikohen në Fletoren Zyrtare. Çdo referim ligjor ndaj standardeve shqiptare të harmonizuara do të ketë karakter tregues.

5. Ministritë, institucionet qendrore dhe organet e pushtetit vendor, të cilat përgatisin rregulla teknike, që përmbajnë referime ndaj standardeve shqiptare ose pjesëve të këtyre standardeve, për zbatim në nivel kombëtar, bashkëpunojnë me DPS-në për mënyrën e referimit.

6. Një rregull teknik do t’u referohet standardeve shqiptare, të cilat adoptojnë standarde europiane ose ndërkombëtare, vetëm nëse këto standarde janë adoptuar nga DPS-ja dhe janë publikuar si standarde shqiptare në njërën nga dokumentet e saj.

KREU II

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E STANDARDIZIMIT

Neni 8

Organi kombëtar i standardizimit

1. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit është organizmi kombëtar i standardizimit në Republikën e Shqipërisë për hartimin, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve në të gjithë sektorët e ekonomisë, me përjashtim të atyre të fushës së telekomunikacionit.

2. DPS-ja është person juridik, publik, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë dhe e ka qendrën në Tiranë.

3. DPS-ja drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm, që emërohet dhe shkarkohet nga ministri përgjegjës për ekonominë.

4. Struktura dhe organika e DPS-së propozohen nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe miratohen nga Kryeministri. Punësimi i punonjësve të DPS-së rregullohet nga Kodi i Punës, legjislacioni përkatës në fuqi dhe rregullorja e brendshme e kësaj drejtorie.

5. DPS-ja është Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pika Kombëtare e Referimit në OBT për standardet, rregullat teknike dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit me ndikim në tregti. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit është Autoriteti Kombëtar i Notifikimit dhe Pika Kombëtare e Referimit në OBT për masat sanitare dhe fitosanitare me ndikim në tregti.

Autoriteti Kombëtar i Notifikimit, gjatë ushtrimit të këtij funksioni, informon periodikisht njësinë e OBT-së pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për çdo notifikim të saj pranë OBT-së.

6. DPS-ja është institucion buxhetor, me buxhet më vete. DPS-ja, të ardhurat e përftuara nga shërbimet e veta, do t’i përdorë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 9

Përfaqësimi

DPS-ja përfaqëson Republikën e Shqipërisë në Organizatën Ndërkombëtare të Standardizimit (ISO), në Komisionin Ndërkombëtar të Elektroteknikës (IEC), në Komitetin Europian të Standardizimit (CEN) dhe në Komitetin Europian për Standardizimin në Fushën e Elektroteknikës (CENELEC).

Neni 10
Organet drejtuese

1. Organet drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit janë bordi drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm.

2. Krijimi, përbërja, kompetencat dhe funksionimi i bordit drejtues të DPS-së përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11
Bordi teknik

1. Bordi teknik është organ teknik i DPS-së dhe nuk bën pjesë në organikë.

2. Në bordin teknik marrin pjesë vullnetarisht përfaqësues nga palët e interesuara për standardizimin.

3. Përbërja, kompetencat dhe funksionimi i bordit teknik miratohen nga bordi drejtues.

Neni 12
Komitetet teknike

1. Komitetet teknike të standardizimit janë organizmat e punës së DPS-së, që nuk bëjnë pjesë në organikë dhe aktivizohen për fusha të caktuara të standardizimit.

2. Komitetet teknike krijohen dhe shpërndahen nga bordi teknik.

3. Pjesëmarrja në komitetet teknike është vullnetare, e hapur për të gjitha palët e interesuara dhe pa pagesë.

Neni 13
Anëtarësimi

Çdo person fizik dhe/ose juridik, që ushtron veprimtari në Republikën e Shqipërisë, mund të bëhet anëtar i DPS-së. Të drejtat, detyrimet dhe kuota e anëtarësimit përcaktohen me marrëveshje ndërmjet palëve, sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të DPS-së.

Neni 14
Kompetencat

Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit ushtron këto kompetenca:

a) harton dhe miraton rregullat dhe procedurat e punës për veprimtaritë kombëtare të standardizimit, në zbatim të veprimtarive të organizatave europiane të standardizimit;

b) përgatit, miraton dhe publikon programin e punës së standardizimit, në përputhje me interesat e palëve të interesuara për standardizimin;

c) harton, adopton, miraton, zbaton, ndryshon, shfuqizon, publikon standardet shqiptare dhe dokumentet shqiptare të standardizimit;

ç) adopton dhe publikon standardet europiane dhe ndërkombëtare në fuqi si standarde shqiptare;

d) zbaton parimet dhe rregullat e ndjekura nga organizatat europiane dhe ndërkombëtare të standardizimit;

dh) përgatit dhe mirëmban bazën e të dhënave për standardet dhe dokumentet e standardizimit;

e) përgatit dhe mirëmban arkivin me standarde kombëtare, ndërkombëtare, europiane, standardet kombëtare të huaja, si dhe një mjedis të specializuar për shitjen e tyre;

ë) ofron shërbime informacioni, në përputhje me kërkesat e organizmave vendas dhe të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj;

f) zbaton detyrimet si Autoritet Notifikues dhe Pikë Referimi, të cilat rrjedhin si rezultat i marrëveshjes me Organizatën Botërore të Tregtisë për barrierat teknike në tregti dhe të kodit të praktikës së mirë për hartimin, adoptimin dhe zbatimin e standardeve;

g) zbaton detyrimet, që rrjedhin nga zbatimi i direktivës së Bashkimit Europian 98/34/EC, datë 22 qershor 1998, të ndryshuar, "Për dhënien e informacionit në fushën e standardeve dhe rregullave teknike dhe rregullave për shërbimet e informimit të shoqërisë";

gj) shkëmben informacion dhe bashkëpunon në fushën e standardizimit me organizma kombëtarë të standardizimit të vendeve të tjera;

h) organizon trajnime dhe veprimtari për standardizimin;

i) publikon buletinin dhe katalogun e standardeve shqiptare në periudha të përcaktuara;

j) publikon raportin vjetor të veprimtarive në vitin pararendës;

k) nxit studimet, publikimet, përvojën dhe punën kërkimore për standardizimet, si dhe veprimtari të tjera, që kanë lidhje me standardizimin;

l) i propozon ministrisë përgjegjëse për ekonominë aktet ligjore dhe nënligjore për veprimtaritë që mbulon;

ll) i propozon Ministrisë së Financave tarifat për çmimet e shërbimeve, që kryhen për palët e treta, bazuar në tarifat e organizatave ndërkombëtare e europiane dhe kushtet e vendit.

Neni 15

Hartimi, adoptimi, miratimi dhe publikimi i standardeve shqiptare

1. Çdo person fizik dhe/ose juridik mund t'i paraqesë DPS-së një propozim, të shoqëruar me arsyetimin përkatës, për hartimin, adoptimin dhe miratimin e një standardi shqiptar.

Procedura e hartimit, adoptimit dhe miratimit të standardeve shqiptare duhet të përcaktojë:

a) objektivat që duhen arritur nga standardi i propozuar;

b) faktorët dhe ndikimin ekonomik;

ç) burimet e financimit dhe të ekspertizës;

ç) zbatimet e mundshme të standardit, në kuadër të vlerësimit të konformitetit;

d) lidhjet me standardet e tjera.

2. Standardet europiane dhe ndërkombëtare janë të gatshme për përdorim publik, nëpërmjet adoptimit të tyre si standarde shqiptare.

3. Standardet europiane e ndërkombëtare zbatohen në të njëjtën mënyrë si standarde shqiptare, nëpërmjet:

a) adoptimit, miratimit dhe përgatitjes së një teksti të njëjtë me origjinalin e standardit në gjuhën shqipe;

b) hartimit të faqes së parë në gjuhën shqipe;

c) miratimit me listë si standarde shqiptare.

4. Konfirmimi i miratimit si standarde shqiptare bëhet nëpërmjet përgatitjes së një dokumenti zyrtar miratimi, si dhe me shpalljen në buletinin periodik të DPS-së.

5. Me adoptimin e standardeve europiane si standarde shqiptare, çdo standard shqiptar apo akt tjetër normativ, që bie ndesh me ato europiane, shfuqizohet.

6. Procedura për adoptimin e standardeve europiane dhe ndërkombëtare si standarde shqiptare përcaktohet në rregullat dhe procedurat për veprimtaritë kombëtare të standardizimit.

7. Hartimi, adoptimi, miratimi dhe publikimi i standardeve shqiptare bëhen në përputhje me rregullat dhe procedurat për veprimtaritë kombëtare të standardizimit.

Neni 16

Hartimi, adoptimi dhe miratimi i dokumenteve shqiptare të standardizimit

1. Dokumentet shqiptare të standardizimit hartohen, adoptohen dhe miratohen sipas rregullave dhe procedurave për veprimtaritë kombëtare të standardizimit.

2. Dokumentet shqiptare të standardizimit identifikohen nëpërmjet emërtimit me shkronja dhe numra. Emërtimi me shkronja përbëhet nga shkronjat "DS" (Dokument standardizimi), ose në një kombinim të shkronjave DS dhe emërtime të tjera me shkronja, në rastet e adoptimit të dokumenteve europiane ose ndërkombëtare të standardizimit. Emërtimi numerik përbëhet nga numri i dokumenteve të standardizimit dhe viti i miratimit apo adoptimit të tyre. Këto emërtime nuk do të përdoren për dokumente të tjera standardizimi, përveç dokumenteve shqiptare të standardizimit.

Neni 17

Konfirmimi, ndryshimi, ripunimi dhe shfuqizimi i standardeve shqiptare dhe i dokumenteve shqiptare të standardizimit

1. DPS-ja kontrollon periodikisht dhe konfirmon statusin e standardeve shqiptare, në përputhje me

rregulloren e brendshme të saj.

2. Konfirmimi, ndryshimi, ripunimi dhe shfuqizimi i një standardi shqiptar apo i një dokumenti shqiptar të standardizimit realizohen në përputhje me rregullat dhe procedurat e veprimtarive kombëtare të standardizimit.

Neni 18

E drejta e autorit, e drejta e shitjes dhe pronësia intelektuale

1. E drejta e autorit për formën dhe përmbajtjen e çdo standardi shqiptar apo dokumenti standardizimi i takon DPS-së.

2. DPS-ja ka të drejtën ekskluzive dhe pronësinë intelektuale për publikimin, riprodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e projektstandardeve dhe standardeve shqiptare, të projektdokumenteve dhe të dokumenteve shqiptare të standardizimit.

3. DPS-ja mund të caktojë agjentë apo shpërndarës për shitjen ose shpërndarjen e standardeve shqiptare dhe të dokumenteve shqiptare të standardizimit, me anë të marrëveshjeve me palët.

KREU III
FINANCIMI

Neni 19

Burimet e financimit të DPS-së

Të ardhurat buxhetore të DPS-së sigurohen nga:

a) Buxheti i Shtetit;

b) shitja e standardeve shqiptare dhe të huaja, e projektstandardeve shqiptare dhe të huaja, nga shitja e katalogut, dokumenteve dhe publikimeve të standardizimit;

c) shërbimet e kryera, përfshirë informacionin dhe trajnimin;

ç) pjesëmarrja në programe donatorësh dhe/ose projekte, që kanë qëllime të caktuara financimi, qofshin këto europiane, ndërkombëtare apo të çdo lloji tjetër;

d) donacione apo grante nga personat fizikë dhe/ose juridikë;

dh) kuotat nga anëtarësimi në DPS.

KREU IV
SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 20

Kundërvajtjet administrative

Rastet e shkeljeve të dispozitave të këtij ligji përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:

a) çdo person fizik apo juridik, që pretendon pronësinë intelektuale dhe riprodhon, regjistron ose publikon, në çdo mënyrë ose formë, standarde apo projektstandarde shqiptare ose dokumente të standardizimit dhe i shet ato në kundërshtim me pikën 2 të nenit 18 “E drejta e autorit, e drejta e shitjes dhe pronësia intelektuale” të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 200 000 lekë;

b) çdo person fizik apo juridik, që vepron në kundërshtim me pikën 3 të nenit 18 “E drejta e autorit, e drejta e shitjes dhe pronësia intelektuale” të këtij ligji dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 300 000 lekë.

Neni 21

Ankimi

Kundërvajtësi, brenda 5 ditëve nga vënia e gjobës, mund të bëjë ankim në gjykatë, sipas Kodit të Procedurës Civile.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 22
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, në përputhje me nenet 8 pika 5, 10 pika 2, 14 pika 1 shkronjat "f" dhe "g" të këtij ligji, të nxjerrë akte nënligjore.

Neni 23
Vlefshmëria e standardeve shqiptare

Standardet shqiptare, të emërtuara me shkronjat "SSH", të cilat janë miratuar ose adoptuar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, e ruajnë vlefshmërinë edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 24
Shfuqizime

Ligji nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", si dhe çdo dispozitë tjetër, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5625, datë 18.2.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

VENDIM
Nr.157, datë 14.2.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË PËRBËRJEN E KOMISIONIT HETIMOR "MBI PËRGJIMET E PALIGJSHME TË TELEFONAVE"

Në mbështetje të nenit 77 pika 2 të Kushtetutës, të neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.8891, datë 2.5.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit", të vendimit nr.128, datë 11.10.2007 të Kuvendit, me propozimin e Grupit Parlementar LSI+PDS,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Deputeti Spartak Braho caktohet anëtar i Komsionit Hetimor "Mbi përgjimet e paligjshme të telefonave" në vend të zotit Sabit Brokaj.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË 600 lekë
2. REGJISTRAT E NOTERISË 1000 lekë

BOTIME TË REJA
(Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë

- Vendime të Gjykatës Kushtetuese 700 lekë
- Vendime të Gjykatës së Lartë 1000 lekë
- Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil 200 lekë
- Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave 273 lekë
- Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme
  (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)

Hyri në shtyp më 19.2.2008
Doli nga shtypi më 19.2.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2008

Çmimi 44 lekë